

Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë
MISIONI NË KOSOVË

Departamenti për të drejtat e njeriut dhe komunitete

**Komunitetet jo shumicë të Kosovës në sistemet
arsimore të nivelit fillor dhe të mesëm**

Prill 2009

PËRMBAJTJA

PËRMBLEDHJA EKZEKUTIVE	1
1. HYRJE	1
2. QASJA NDAJ ARSIMIT DHE CILËSIA E TIJ	3
2.1. Qasja në shkollim dhe tekste shkollore në gjuhën amtare	3
2.2. Mësimdhënësit, trajnimi i mësimdhënësve dhe menaxhimi i shkollave.....	8
3. NDARJA E SISTEMEVE TË ARSIMIT DHE PENGESAT NË PUNËN E SHKOLLAVE SHUMËETNIKE	16
4. PREZANTIMI I KOMUNITETEVE TË KOSOVËS NË TEKSTET SHKOLLORE	20
5. MËSIMI I GJUHËS ZYRTARE NGA STUDENTËT JOSHUMICË	25
6. PËRFUNDIME DHE REKOMANDIME	26
7. SHTOJCA 1. Të anketuarit nga OSBE-ja, të ndarë sipas bashkësisë, gjinisë dhe kategorisë (janar-shkurt 2009)	29
7. SHTOJCA 1. Të anketuarit nga OSBE-ja, të ndarë sipas bashkësisë, gjinisë dhe kategorisë (janar-shkurt 2009)	29
8. SHTOJCA 2. Përbërja etnike e Kosovës më 2005 dhe lista e profesioneve ku OSBE-ja ka bërë intervista për qëllimet e këtij raporti	30

“Arsimi shumë-kulturor përfshin politikat dhe praktikat arsimore, që plotësojnë nevojat e veçanta arsimore të grupeve shoqërore, që i përkasin traditave të ndryshme kulturore, ndërsa arsimi ndërkulturor përfshin politikat dhe praktikat arsimore përmes së cilave pjesëtarët e kulturave të ndryshme, qofshin ata në pozitën e shumicës apo të pakicës, mësojnë të ndërveprojnë me njëri-tjetrin në mënyrë konstruktive. Arsimi ndërkulturor ka për synim të nxjerrë në pah ruajtjen e identitetit të secilit grup, që shoqërohet me parimin e larmisë dhe të tolerancës. Në këtë kuptim, arsimi ndërkulturor kërkon, që si pakica ashtu edhe shumica të mësojnë për njëri tjetrin, për karakteristikat e veçanta kulturore, historitë e tyre përkatëse dhe për vlerën e tolerancës dhe të pluralizmit.”

Seminari Ndërkombëtar i Montrealit mbi Arsimin Ndërkulturor dhe Shumë-kulturor, 31 mars 2000, paragrafi 6, E/CN.4/Sub.2/AC.5/2000/WP.4, Kombet e Bashkuara Këshilli për të drejtat e njeriut, Nën-komisioni për promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut, grupi punues për minoritete, seanca e gjashtë.

PËRMBLEDHJA EKZEKUTIVE

Ky raport përqendrohet në sistemin ekzistues të arsimit fillor dhe të mesëm në Kosovë dhe Serbi shtjellon tri çështjet kyçe: mbrojtjen e identitetit dhe të drejtave të komuniteteve joshumicë në arsim; mënyrën se si shkollat e ndara me planprograme të Serbisë dhe Kosovës dështojnë në mbështetjen e dialogut ndëretnik, respektin, mirëkuptimin dhe tolerancën ndaj të tjerëve; dhe ofrimin e mundësive nxënësve të komuniteteve joshumicë përmes orëve plotësuese për mësimin e gjuhëve zyrtare. Ky raport bazohet në një hulumtim të gjerë të bërë në terren dhe intervista me të anketuarit, pjesëtarë të të gjitha komuniteteve, që është realizuar nga Misioni i OSBE-së në Kosovë (në tekstin e mëposhtëm: OSBE-ja) në janar dhe shkurt të vitit 2009. Në raport mësohet që ende nuk është hartuar planprogrami për lëndët kombëtare të komuniteteve të veçanta si ai rom, ashkali, egjiptianë, goranë, kroatë dhe malazez. Pamjaftueshmëria e teksteve shkollore në gjuhën turke dhe në atë boshnjake për arsimin fillor dhe mungesa e tyre për arsimin e mesëm ndikon negativisht në cilësinë e shkollimit dhe pengon mësimin e duhur të lëndëve kombëtare. Mosmarrëveshjet mbi kompetencat, ndarja fizike e sistemeve të shkollimit, fakti që në kuadër të dy sistemeve nuk ofrohet mësimi i gjuhës tjetër zyrtare, nuk bëhen përpjekje të vazhdueshme për mbështetjen e këmbimit ndërmjet mësimdhënësve dhe nxënësve shqiptarë dhe serbë, si dhe përmbajtja e teksteve shkollore të historisë dhe e teksteve tjera, që të gjitha këto i kontribuojnë ndarjes së mëtejme dhe vënë në pikëpyetje funksionimin e shkollave shumë-etnike, ku bëhet integrimi i fëmijëve që i përkasin të gjitha sistemeve dhe komuniteteve. Vijimi i pamjaftueshëm dhe jo i duhur në gjuhën shqipe për komunitetet joshqiptare rezulton në njohje të dobët të gjuhës, mundësi të pakta të integritit në shkollim dhe punësim si dhe konkurrencë të pabarabartë për nxënësit jo-shqiptarë. Ndonjëherë, mundësia e shoqërimit me moshatarë të komunitetit kosovar shqiptar kontribuon në mësimin e kësaj gjuhe.

1. HYRJE

Legjislacioni i aplikuar në Kosovë parashikon të drejta gjithëpërfshirëse dhe të veçanta për shkollimin e komuniteteve joshumicë.¹ Këtu përfshihen e drejta për vijim në shkolla publike në të gjitha nivelet, në njërin prej gjuhëve zyrtare (shqipe ose serbe). Në zonat e banuara me persona që i përkasin komuniteteve, gjuha amtare e të cilëve nuk është gjuhë zyrtare, këta persona që ju takojnë këtyre komuniteteve kanë të drejtë të shkollimit publik në nivelin parashkollor, fillor dhe të mesëm, në gjuhën e tyre amtare. Aty, ku për shkak të numrit të pamjaftueshëm të nxënësve ose për ndonjë arsye tjetër, nuk ofrohet mundësia e shkollimit në gjuhën e zgjedhur zyrtare ose të komunitetit, duhet të sigurohen alternativa tjera. Së këndejmi, dispozitat ligjore në fuqi poashtu ua njohin të drejtën e komuniteteve për ngritjen e objekteve private për shkollim dhe aftësim dhe përgatitjen e njësive mësimore mbi kulturën, historinë dhe

¹ Me datën 15 Qershor 2008, Kosova ka nxjerr Ligjin për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të komuniteteve dhe pjesëtarëve të tyre në Kosovë (Ligji për të drejtat e komuniteteve, 2008) Neni 1,4 i përkufizon komunitetet si “grupe kombëtare, etnike, kulturore, gjuhësore apo fetare tradicionalisht të pranishëm në Kosovë, të cilat nuk janë shumicë”. Këto grupe janë komuniteti serbë, turk, boshnjakë, romë, ashkali, egjiptianë, goranë dhe komunitete tjera (siç janë kroatët dhe malazezët). Veç kësaj, neni 1,4 poashtu përkufizon se pjesëtarët e komunitetit shumicë në Kosovë, të cilët si tërësi nuk janë shumicë në një komunë të caktuar duhet poashtu të i gëzoj të drejtat e përshkruara në këtë ligj. . Këtu përfshihet komuniteti shqiptar në komunën e Mitrovicës Veriore, Zveçanit, Leposaviqit dhe Shtërpçës poashtu konsiderohen komunitet joshumicë për qëllim të legjislacionit të aplikueshëm.

traditën e tyre. Dispozitat në fuqi gjithashtu kërkojnë që planprogrami mësimor të mbulojë historinë, kulturën dhe veçoritë e tjera të komuniteteve tradicionalisht të pranishme në Kosovë dhe të nxisë frymën e respektit, të mirëkuptimit dhe të tolerancës ndërmjet të gjitha komuniteteve. Autoritetet kosovare kanë zhvilluar strategji shumë-vjeçare për shkollimin para universitar dhe përfshirjen në shkollim të nxënësve romë, ashkali dhe egjiptianë,² kanë organizuar orë plotësuese për 1,800 nxënës romë, ashkali dhe egjiptianë nga viti 2004 deri 2007,³ dhe kanë përfituar nga programet e asistencës teknike për mbështetjen e procesit të reformës së planprogramit.⁴

Në praktikë, ekzistojnë dy sisteme shkollore konkurrenente dhe të ndara. Nxënësit shqiptarë vijnë në mësimin pa asnjë orë në gjuhën serbe, ndërsa nxënësit serbë vijnë në mësimin sipas planprogramit dhe shkollave të drejtuara nga Serbia, pa asnjë orë në gjuhën shqipe. Sistemi shkollos i Kosovës ofron planprograme për mësimin fillor dhe të mesëm në gjuhën amtare si në atë: shqipe, turke dhe boshnjake, por jo në atë serbe. Sistemi për njohjen e planprogrameve dhe teksteve shkollore të Serbisë për përdorim në nivel komunal nuk është vendosur ende.⁵ Sistemi shkollos serb ofron mësim vetëm në gjuhën serbe, me shembuj të shpërndarë të mbajtjes së orëve të gjuhës rome, kroate, boshnjake dhe shqipe⁶ në një numër të kufizuar të shkollave. Asnjë sistem mësimor nuk përmban planprograme ose tekste shkollore të veçanta ose të përshtatura si duhet kulturës dhe historisë së komuniteteve romë, ashkali, egjiptianë, goranë, kroatë dhe malazezë. Deri në një masë të caktuar, planprogramet dhe sistemet e ndara mbulojnë nevojat mësimore ndërkulturore të disa komuniteteve, por dështojnë në promovimin e mësimit ndërkulturore dhe mbështetjes së shkëmbimeve ndërmjet mësimdhënësve dhe nxënësve të të dy sistemeve. Në ndërkohë, nuk ekziston ndonjë shifër zyrtare sa i përket vijimit të nxënësve në shkollat me planprogram serb në Kosovë,⁷ Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (në tekstin e mëposhtëm: Ministria e Arsimit) vlerëson që, në vitin shkollor 2006/7, 13,446 (3.06 përqind) prej 439,445 nxënësve që kanë ndjekur mësimin fillor dhe të mesëm me planprogram të Kosovës, i përkisnin komuniteteve joshumicë.⁸

² Strategjia për zhvillimin e arsimit para universitar në Kosovë, 2007-2017. Strategjia për integrimin e komuniteteve romë, ashkali dhe egjiptianë në arsimin e Kosovës, 2007-2017. Strategjia për integrimin e komuniteteve romë, ashkali dhe egjiptianë në Kosovë, 2009-2015, është zhvilluar me mbështetjen e OSBE-së dhe përmban një kapitull të veçantë për arsimin.

³ Me mbështetjen e OSBE-së, Ministria e Arsimit e ka realizuar këtë projekt në nëntë komuna.

⁴ Mbështetja e UNICEF-it për zhvillimin e kornizës së planprogramit të ri para universitar; 'Ndërkulturalizmi dhe Procesi i Bolonjës' i Këshillit të Evropës dhe 'Zhvillimi Institucional i Kosovës për Programin Arsimor'.

⁵ Me 21 Maj, Kosova ka nxjerr Ligjin për arsim në komunat e Kosovës (2008 Ligji për Arsim). Parashih Komisionin e Pavarur për shqyrtimin e materialeve mësimore në gjuhën serbe, i cili ende nuk është themeluar.

⁶ Kjo i përket vetëm lëndëve të planprogramit serb që vijohen nga nxënësit goranë në Dragash.

⁷ Megjithatë, sipas draftit "Strategjia për jetesë të qëndrueshme dhe kthim në Kosovë e Metohi" (fq. 15) të lëshuar nga Ministria serbe për Kosovë e Metohi në mars 2009, për vitin shkollor 2008/2009, janë pranuar gjithsej 19,530 nxënës, 177 prej tyre në shkollë fillore dhe 48 në shkollë të mesme, të menaxhuar nga Ministria serbe e arsimit në Kosovë..

⁸ Burimi: Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, Indikatorët dhe të dhënat statistikore në arsim, 2004/05, 05/06, 06/07, Prishtinë, fq. 103, tabela 7. Kjo shifër përfshin 4,504 nxënës (1.02 përqind) boshnjakë, 3,053 turq, 2,899 ashkali, 1,265 goranë, 1,086 egjiptianë, 548 romë dhe 70 kroatë. Këto statistika përfshijnë nxënësit goranë dhe kroatë, që në fakt vijnë në mësimin sipas planprogramit serb. Nxënësit serb dhe romë që vijnë në njëtin planprogram nuk janë të përfshirë.

Me vazhdimin e tryezave të rrumbullakëta të mbajtura më parë për arsimin e komuniteteve,⁹ për vlerësimin e progresit të shënuar sa i përket disponueshmërisë dhe cilësisë së shkollimit për komunitetet joshumicë, OSBE-ja ka zhvilluar intervista dhe diskutime nëpër të gjitha rajonet, komunat, qytetet¹⁰ dhe fshatrat e Kosovës, ku këto komunitete kanë qasje në sistemin mësimor të Kosovës ose atë të Republikës së Serbisë. Intervistat janë zhvilluar me nxënësit e arsimit fillor dhe të mesëm, me mësimdhënësit dhe drejtorët e shkollave, prindërit dhe përfaqësuesit e drejtorive komunale për arsim nga komunitetet joshumicë. Numri i përgjithshëm i personave të anketuar është 738, ku 295 prej tyre janë femra (40 përqind), duke përfshirë 235 serbë, 136 romë, 92 ashkali, 82 boshnjakë, 62 turq, 53 shqiptarë, 35 goranë, 26 egjiptianë dhe 17 kroatë (shih Shtojcën 1). Kjo qasje mundësoi grumbullimin e informatave sa i përket mendimeve, nevojave, shqetësimeve dhe interesave të komuniteteve lidhur me shkollimin që u ofrohet atyre. Nëse veçohet e kundërta, terminologjia e sotme që përdoret në raporte i referohet që të dyjave femrave dhe meshkujve.

Kapitujt vijues përmbajnë rezultate dhe vështrime sa i përket qasjes në arsim dhe cilësisë së arsimit për komunitetet joshumicë, ndarjen e sistemeve mësimore si dhe pengesat në funksionimin e shkollave shumë etnike, në të cilat ndërveprojnë nxënësit e të dy sistemeve. Për më tepër, kjo shpjegon mënyrën me të cilën përfaqësohen identitetet dhe historitë e komuniteteve të Kosovës në kuadër të dy sistemeve arsimore në Kosovë si dhe rregullimi i çështjeve për të siguruar që fëmijët, të cilët vijnë në mësimin në gjuhët jozyrtare munden gjithashtu t'i mësojnë gjuhët zyrtare.

2. QASJA NDAJ ARSIMIT DHE CILËSIA E TIJ

2.1. Qasja në shkollim dhe tekste shkollore në gjuhën amtare

Legjislacioni i Kosovës njuh të drejtën për të vijuar shkollimin publik në të gjitha nivelet në gjuhën e zgjedhur zyrtare¹¹ dhe të drejtën për të vijuar mësimin parashkollor, fillor dhe të mesëm në gjuhët tjera të komuniteteve tradicionale të Kosovës, aty ku jetojnë këto komunitete.¹² Në praktikë, nxënësit goranë kanë

⁹ Tyeza e rrumbullakët për arsimin e komunitetit boshnjak, (16 tetor, 2007, Reçan), turk (23 tetor, 2007, Prizren) dhe goran (30 tetor, 2007, Dragash), e organizuar nga OSBE-ja, Ministria e Arsimit, Këshilli i Evropës, Kombet e Bashkuara, Misioni në Kosovë dhe UNICEF-i.

¹⁰ Shtërpçë/Štrpce; Gjilan/Gnjilane; Novobërdë/Novo Brdo; Kamenicë/Kamenica; Ferizaj/Uroševac; Viti/Vitina; Obiliq/Obilić, Caravodicë/Crkvena Vodica, Babimoc/Babin Most dhe Plemetin/Plementina (Obiliq/Obilić); Fushë-Kosovë/Kosovo Polje; Lipjan/Lipjan, Hallaq i Vogël/Mali Alas dhe Janjevë/Janjevo (Lipjan/Lipljane); Podujevë/Podujevo; Shtime/Štimlje ;Mitrovicë/Mitrovica jugore dhe veriore; Zveçan/Zveçan; Zubin Potok; Leposaviq/Leposavić ; Skenderaj/Srbica; Vushtrri/Vučitri; Pejë/Peć, Gorazhdëc/Gorazhdëvac, Sigë/Siga dhe Brestovik/Brestovik (Pejë/ Peć); Istog/Istok dhe Osojane/Osojan (Istog/Istok); Klinë/Klina; Deçan/Deçane; Prizren, Pllanjanë, Reçanë(Prizren);Mamushë/Mamusa;Dragash/Dragaš,Mlikë/Mlike, Gllloboçicë/Globocica Lubovishtë/Ljuboviste , Brod dhe Krushevë (Dragash); Rahovec dhe Hoçë e Madhe/ Velika Hoça (Rahovec/ Orahovac).

¹¹ Neni 4.4(b), Korniza Kushtetuese,Rregullorja e UNMIK-ut 2001/9 15 Maj 2001 dhe modifikimet e më pasme (Korniza Kushtetuese) Neni 19.1 Ligjin mbi përdorimin e gjuhëve, Rregullorja e UNMIK-ut 2006/51 (Ligji për përdorimin e gjuhëve), neni 59.2, Kushtetuta e shpallur më 15 Qershor 2008 (Kushtetuta 2008) neni 8.1, Ligji për të drejtat e komuniteteve, 2008.

¹² Neni 4.4(b), Korniza Kushtetuese; neni 3.2(c), Ligjin mbi arsimin fillor dhe të mesëm në Kosovë Rregullorja e UNMIK-ut nr. 2002/19, 31 Tetor 2002 (Ligjin mbi arsimin fillor dhe të mesëm); neni

vështirësi për qasje në planprogramet mësimore serbe siç dëshirojnë ata. Nxënësit boshnjakë, të cilët vijnë në mësim sipas planprogrameve serbe, konsiderojnë që këtij të fundit i mungon ndjeshmëria dhe adaptimi me larminë e tyre kulturore. Nxënësit romë kanë qasje për shkollim në gjuhën e tyre amtare vetëm në disa shkolla me sistem të planprogramit serb. Në kuadër të planprogramit të Kosovës, nxënësit boshnjakë dhe turq kanë qasje në shkollim në gjuhën e tyre amtare, por nuk ka tekste shkollore në gjuhët e tyre për arsimin e mesëm, e në disa as për atë fillor. Nxënësit shqiptarë në Kosovën veriore kanë qasje në shkollimin fillor në gjuhën e tyre amtare, por nuk kanë mbështetje nga komunat e tyre.¹³ Komuniteti goranë, kroat, rom, ashkali, egjiptian dhe malazez nuk kanë qasje në shkollim me lëndë arsimore të komunitetit të veçantë, që të do t'ua mundësonte ruajtjen e identitetit të tyre.

Shkollat me planprograme serbe

Nxënësit, të cilët zgjedhin gjuhën serbe si gjuhë për të mësuar, vijnë në mësim sipas planprogramit serb. Qasja aktuale e tyre në arsim dhe tekste shkollore ndryshon varësisht prej vendit ku jetojnë dhe prej situatës ekonomike. Tekstet shkollore ekzistojnë vetëm në gjuhën serbe. Megjithatë, në sistemin mësimor serb mund të ketë edhe tekste shkollore në gjuhët e tjera, të cilat mund të përdoren¹⁴. Ministria për Arsim e Serbisë i ofron falas tekstet shkollore për nxënësit romë të klasës së parë në rajonet e Mitrovicës dhe të Gjilanit dhe për nxënësit goranë në Dragash, ndërsa nxënësit serb duhet të paguajnë përfaqësisht 60 Euro për një komplet të teksteve për një klasë. Në vitin shkollor 2009/10, tekstet shkollore do të jepen falas për të gjithë nxënësit. Mësimdhënësit, prindërit dhe nxënësit i lavdërojnë tekstet shkollore dhe planprogramin.

Në përgjithësi, serbët nuk përballen me vështirësi për qasje në planprograme dhe tekste shkollore për shkollimin fillor dhe të mesëm. Shkollat me planprogram serb në përgjithësi janë në gjendje relativisht të mirë,¹⁵ ofrohet transporti për shkollë dhe me përjashtim të nxënësve romë, shkalla e braktisjes së shkollës është shumë e ultë. Studentët e universitetit udhëtojnë në Mitrovicën veriore (kryesisht me autobusin për transport humanitar të siguruar nga Ministria e Transportit dhe Telekomunikacionit të Kosovës) ose në universitetet në Serbi. Vetëm në Binçë/Binaç (Komuna e Vitisë/Vitina) dhe në qytetin e Vitisë, prindërit i përcjellin fëmijët e tyre në shkollë për arsye të sigurisë. Serbët e zhvendosur kanë qasje të plotë në shkollim në vendin e zhvendosjes së tyre. Megjithatë familjet e zhvendosura serbe me fëmijë të moshës shkollore ende mendojnë që mungesa e qasjes në objektet shkollore në vendin e tyre të origjinës është pengesë e madhe për kthim, dhe së dyti është vetëm mungesa e mundësive për punësim.

Nxënësit goranë përballen me vështirësi të shumta në vijimin e mësimin në gjuhën serbe siç dëshirojnë ata, ndërsa nuk ekziston ndonjë planprogram i Kosovës në këtë gjuhë. Në vitin 2008/9, vazhdimi i arsimit me planprogram serb që zhvillohet në shkollat, të cilat drejtohen nga komuna e Dragashit, sfidohet nga konflikti ndërmjet

20,1 Ligji mbi përdorimin e gjuhës neni 59.3, 2008 Kushtetuta në fuqi; neni 8.1, Ligji për të drejtat e komuniteteve.

¹³ Për shembull, përdorimi i teksteve shkollore në gjuhën shqipe në Preshevë.

¹⁴ Për shembull, përdorimi i teksteve shkollore në gjuhën shqipe në Preshevë.

¹⁵ Shkolla në qytetin e Kamenicës është një përjashtim, e cila ka nevojë urgjente për më shumë hapësirë dhe renovim.

mësimdhënësve goranë dhe komunës. Bazuar në kërkesën e Qendrës Koordinuese për Kosovë e Metohi të Republikës së Serbisë për zgjedhjen ndërmjet kontratave të Serbisë ose të Kosovës, këta mësimdhënës kanë nënshkruar kontratat me Ministrinë e Arsimit të Serbisë që nga viti 2006. Kjo gjë ka shkaktuar konflikt ndërmjet komunitetit goran në njërin anë dhe komunës e komunitetit boshnjak në anën tjetër.¹⁶ Pas refuzimit të tyre për të nënshkruar kontrata me komunën e Dragashit, prej shtatorit të vitit 2008, mësimdhënësve goranë u është ndaluar hyrja në shkollën ‘Nezim Berati/Nebojša Jerković’ (shkollë e drejtuar nga ana e komunës) në qytetin e Dragashit. Si rrjedhojë, fëmijëve goranë u është pamundësuar shfrytëzimi i lokaleve shkollore bashkë me nxënësit shqiptarë dhe boshnjakë, siç kishin vepruar qysh para vitit 1999, si dhe nuk kanë mundur të vijojnë mësimin në gjuhën serbe. Më 3 Mars 2009, pas një marrëveshjeje të arritur nga Komisionari i Lartë për Pakica Kombëtare i OSBE-së, shumica e mësimdhënësve dhe fëmijëve goranë¹⁷ mund të kthehen në shkolla për ta vijuar mësimin nëse rifillohet me gjuhën serbe. Megjithatë, mosmarrëveshjet mbi rregullat e bashkekzistencës së stafit arsimor të dy sistemeve çuan në tërheqje të njëanshme të të gjithë mësimdhënësve goranë më 17 mars 2009. Negociatat janë në vazhdim për të siguruar kthimin e tyre. Nxënësit goranë vijojnë arsimin e lartë në Serbi apo në Ish Republikën Jugosllave të Maqedonisë, ku është në dispozicion arsimit në gjuhë të zgjedhur zyrtare apo në gjuhën që studentët e njohin më mirë.

Nxënësit boshnjakë që vijojnë mësimin sipas planprogramit serb mendojnë se ky sistem siguron zhvillim të mirë arsimor në fusha të ndryshme akademike. Megjithatë, ata theksojnë se mungon ndjeshmëria dhe përshtatja me larminë e tyre kulturore. Nuk ekzistojnë mënyra të veçanta për t’u kujdesur për këta nxënës, si për shembull futja e teksteve shkollore nga Bosnja dhe Hercegovina.

Në sistemin me planprogram serb, ku edhe vijojnë mësimin një numër i konsiderueshëm i nxënësve romë ku gjuha kryesore është serbishtja dhe vetëm disa shkolla fillore të Gjilanit/Gnjilane dhe Kamenicës/Kamenica,¹⁸ Mitrovicë/Mitrovica veriore, Uglare/Uglar (Fushë Kosovë/Kosovo Polje) dhe Janjevë/Janjevo (Lipjan/Lipljan) ofrojnë orë mësimi në gjuhën rome. Tekstet shkollore në gjuhën rome blihen nga Serbia apo Ish Republika Jugosllave e Maqedonisë. Kështu ato nuk hartohen sipas kontekstit kosovar, nuk pasqyrojnë specifikat gjuhësore dhe kulturore të komunitetit lokal rom, shpeshherë janë të vështira për t’u kuptuar nga nxënësit dhe janë të vështirë për t’u blerë.¹⁹ Në Mitrovicë, nxënësit romë kanë numër të kufizuar të teksteve shkollore në gjuhën rome, të cilat i përkasin shkollës dhe nuk mund të merren në shtëpi. Është raportuar se vetëm dy nxënës romë vijojnë arsimin e mesëm me

¹⁶ Përkundër goranëve, boshnjakët kanë zgjedhur arsimin me planprogram të Kosovës në boshnjakisht. Mësimdhënësit goranë ofrojnë arsim me planprogram të Serbisë, dhe nuk nënshkruajnë kontrata me komunën.

¹⁷ Kjo i referohet fëmijëve dhe mësimdhënësve të klasave 5-8 që janë kthyer në shkollë nga 3 -16 Mars 2009. Fëmijët e klasave 1-4 nuk janë kthyer sepse drejtori i shkollës me planprogram kosovar e parandalonte kthimin e dy mësimdhënësve goranë.

¹⁸ Një shkollë fillore në qytetin e Gjilanit, një shkollë fillore në qytetin e Kamenicës dhe shkolla në fshatin e përzier të Berivojcë ofrojnë një orë e gjysmë deri në dy orë në javë.

¹⁹ Sipas mësimdhënësve romë, nxënësit romë mësojnë mbi identitetin e komunitetit të tyre në Serbi apo në Ish Republikën Jugosllave të Maqedonisë, pa referenca për Kosovën. Ata mësojnë gjuhën dhe gramatikën rome ashtu siç shkruhet në Serbi dhe IRJ të Maqedonisë. Mësimdhënësit romë shpeshherë blejnë libra, i kopjojnë dhe i shpërndajnë ato te nxënësit. Disa herë, librat dhurohen nga Serbia.

planprogramin serb. Shumica e nxënësve romë në rajonin e Gjilanit përfundojnë vetëm shkollimin fillor (në shqip apo serbisht) apo braktisin shkollimin. Ata që kanë përfunduar shkollën e mesme, nëse mund ta përballojnë koston apo nëse sigurojnë bursa shkollimi, kryesisht regjistrohen në universitete në Serbi apo në Ish Republikën Jugosllave të Maqedonisë dhe përfundojnë studimet në serbisht apo maqedonisht.

Shkollat me planprogram kosovar

Cilësia dhe disponueshmëria e planprogramit dhe teksteve shkollore kosovare varet nga gjuha në të cilën ato janë hartuar, pra, shqipja, boshnjakishtja dhe turqishtja. Planprogrami kornizë i Kosovës është i ndarë në lëndë të përgjithshme dhe specifike për komunitet në të ashtuquajturat lëndë kombëtare. Këto lëndë janë gjuha, historia, arti dhe muzika. Lëndët kombëtare për turqit dhe boshnjakët hartohen nga ekspertë të komuniteteve përkatëse. Planprogrami dhe tekstet shkollore për lëndët e përgjithshme krijohen nga ekspertë shqiptarë dhe pastaj përkthehen në turqisht dhe boshnjakisht. Në të dyja rastet, përkthimi shpeshherë konsiderohet si i dobët.²⁰

Ligji mbi Arsimin Fillor dhe të Mesëm obligon Ministrinë e Arsimit që të sigurojë tekste shkollore pa pagesë për të gjitha klasat (1-9) e arsimit të obliguar.²¹ Ministria, në bashkëpunim me komunat, është po ashtu përgjegjëse për t'i siguruar nxënësve tekste adekuate shkollore "në gjuhët e tyre amtare."²²

Në komunat në pjesën veriore të rajonit të Mitrovicës, nxënësit shqiptarë kanë qasje në planprogramin kosovar. Megjithatë, blerja e teksteve shkollore viteve të kaluara ka qenë pengesë, veçanërisht për enklavat ekonomikisht të veçuara shqiptare të Zvečan/Zvečan dhe Leposavić/Leposaviq. Prej vitit 2008, Ministria e Arsimit ka siguruar tekste shkollore pa pagesë për nxënësit e shkollës fillore. Po ashtu, kushtet e rënda ekonomike ndikojnë në mospërballim të kostove shkollore për nxënësit ashkali në këtë rajon, që rezulton me mosregjistrim dhe braktisje të shkollës. Ata shpeshherë mbështeten në donacione për tekste shkollore dhe mbështetje tjera nga Ministria e Arsimit, organizatat ndërkombëtare apo donatorët privatë.

Mungesa e teksteve shkollore të bazuara në planprogram ndikon në masë të madhe në cilësinë e shkollimit në gjuhë amtare për gjuhët boshnjake dhe turke. Nuk ekzistojnë fare (për shkollimin e mesëm të lartë, klasat 10-13), apo ka shumë pak, (për shkollim e mesëm të ulët, klasat 6-9) libra shkollorë të bazuar në planprogram në këto gjuhë.²³ Në vitin 2008/9, nxënësit e gjuhës boshnjake dhe turke kanë pranuar tekste shkollore jokomplete²⁴ pa pagesë të klasave 1-5 nga Ministria e Arsimit. Zyrtarë të arsimit në

²⁰ Përkthimi konsiderohet si dobët edhe nga aspekti teknik edhe nga ai përmbajtjesor për shkak të zotërimit të dobët të gjuhës së përkthyesve apo faktit se ata nuk janë të njohur me gjuhën e teksteve shkollore.

²¹ Neni 3.2 (b), Ligji mbi Arsimin Fillor dhe të Mesëm në Kosovë.

²² Neni 7.6, Ligji mbi Arsimin Fillor dhe të Mesëm në Kosovë.

²³ Për shembull, nxënësit boshnjakë në Zllapek (Pejë) dhe Dobrushë (Istog), kanë mungesë të teksteve të lëndëve të përgjithshme dhe librave të historisë për klasat 6-9.

²⁴ Gjersa Ministria e Arsimit ka investuar 200,000 Euro në 2008/9, disa libra në gjuhën boshnjake dhe turke nuk janë në dispozicion apo vetëm mund të blihen. Për shembull, në Prizren prej tetorit 2008, nuk kishte në dispozicion libra të lëndëve kombëtare në vijim: Abetarja në boshnjakisht (klasa 1), Libër Leximi në boshnjakisht (klasat 4-5), Art në boshnjakisht (klasat 3 dhe 5) dhe muzikë në boshnjakisht (klasat 3-5), teste leximi në turqisht (klasa 5). Nuk ka në dispozicion tekste shkollore të muzikës në turqisht dhe abetarja në turqisht nuk është botuar fare në Kosovë. Këta libra janë

Pejë konfirmojnë mungesën e teksteve shkollore dhe theksojnë se shtypja e plotë dhe sigurimi i teksteve shkollore në gjuhën boshnjake, posaçërisht në lëndët kombëtare vështirësohet për shkak të numrit të vogël të autorëve të kualifikuar dhe fitimit të pamjaftueshëm apo madje dhe humbjes ekonomike që ka të bëjë me botimin e kufizuar të librave. Shtëpitë e botimit pësojnë humbje kur lëshojnë në qarkullim më pak se 1,000 kopje për libër, gjersa – në tërë Kosovën – asnjë gjeneratë nuk ka më shumë se 200 nxënës boshnjakë. Prandaj, është i domosdoshëm subvencionimi i botimit nga Ministria e Arsimit. E njëjta vlen për librat në gjuhët turke.

Në Prizren, Prishtinë/Pristina, Mamushë/Mamuša dhe Gjiilan/Gnjilane,²⁵ nxënësit turq kanë qasje në të gjitha nivelet e shkollimit deri në shkollimin e mesëm (apo të lartë në Prizren) në gjuhën e tyre amtare. Kurset e gjuhës turke janë në disponueshmëri në Prizren (Fakulteti i Edukimit) dhe në Prishtinë/Pristina (Fakulteti Filologjik).

Megjithatë, shumë tekste shkollore ende nuk janë në dispozicion, duke krijuar kështu një situatë të pafavorshme karshi nxënësve shqiptarë, veçanërisht për sa i përket provimeve pranuese në shkollimin e mesëm dhe të lartë. Nxënësit shpeshherë shfrytëzojnë libra të importuar nga Turqia dhe, në disa raste, dorëshkrime nga ligjëratat e mësimdhënësve. Shumica e kohës së mësimi shfrytëzohet për ligjërime dhe diktime, që shpeshherë shikohet si metodë e njëanshme apo në papajtueshmëri me planprogramin dhe nuk lejon ndërveprime apo pyetje të nxënësve.

Në komunën e Pejës, nxënësit, prindërit dhe mësimdhënësit boshnjakë kanë theksuar mungesën e teksteve shkollore në boshnjakisht. Këta libra ose nuk janë përgatitur ende apo nuk janë shtypur, apo shpërndarja e tyre është vonuar. Mësimdhënësit, po ashtu, kanë përmendur dallimet në shpërndarjen e librave shkollorë ndërmjet rajoneve dhe shkollave dhe konfirmojnë se disponueshmëria e përgjithshme e teksteve shkollore në boshnjakisht ende nuk është materializuar. Veç kësaj, shumica e librave të lëndëve kombëtare nuk janë të bazuar në planprogram, importohen nga Bosnja dhe Hercegovina dhe janë të vjetruara apo grisura nga përdorimi intensiv. Mungesa e librave prek edhe nxënësit e shkollës së mesme profesionale në Zllapek (Pejë), dhe shkollën e mesme në Pejë. Kështu, nxënësit më së shumti i ekspozohen mjedisit të tillë të shkollimit ku vetëm dëgjojnë dhe marrin shënime. Ata mendojnë se librat e edukatës qytetare, të historisë dhe të gjuhës boshnjake nuk pasqyrojnë apo e bëjnë atë në mënyrë joadekuate, tiparet specifike të komunitetit boshnjak në Kosovë. Rreth 70 për qind të këtyre nxënësve regjistrohen në shkollim të lartë, ndonëse numri i ligjërimeve në gjuhën boshnjake në Universitetin e Prishtinës janë të kufizuara. Shumica e regjistrimeve bëhen në Fakultetin e biznesit dhe menaxhmentit në Pejë, gjersa regjistrimi dhe shfrytëzimi i konvikteve në Fakultetin e edukimit në Prizren apo në Prishtinë (ku shkollimi është vetëm në gjuhën shqipe) është në shumë raste shumë i shtrenjtë.

Në rajonin e Gjiilanit/ Gnjilane, fëmijët e komunitetit të vogël boshnjak mësojnë tërësisht në shqip, meqë nuk ekziston fare planprogrami në boshnjakisht. Nxënësit

importuar nga IRJ e Maqedonisë dhe vetëm mund të blihen. Tekstet shkollore në turqisht të zhvilluara në Kosovë janë dispozicion vetëm në librari. Po ashtu, ka mungesë të librave shkollorë të lëndëve të përgjithshme në Prizren: Matematika (klasa 3 dhe 5), Punë praktike (klasa 5), Natyrë (klasa 5), dhe Edukatë qytetare (klasa 5) në turqisht; dhe Matematika (klasat 1,2 dhe 5), Natyra dhe Edukata qytetare (klasa 5) në boshnjakisht. Në tërë Kosovën, librat e klasës së pestë në boshnjakisht ende nuk janë në dispozicion.

²⁵ Tri shkolla sigurojnë planprogram kosovar në turqisht në Gjiilan.

goranë vijoje mësimin në sistemin kosovar në shqip në Ferizaj/Uroševac, dhe sistemin serb në Kamenicë/Kamenica. Në Mitrovicë/Mitrovica dhe Vushtri/, Vuçitrn turqit vijoje mësimin sipas planprogramit kosovar në shqip meqë nuk kanë kërkuar ligjërim fillor apo klasa në gjuhën e tyre amtare.²⁶ Megjithatë, disa nga ta kanë vazhduar shkollimin e mesëm në shkollën në gjuhën turke në Prishtinë/Priština. Në Janjevë/Janjevo (Lipjan/Lipljane), nxënësit turq vijoje mësimin sipas planprogramit kosovar në shqip. Përfaqësuesi i komunitetit ka shprehur interesim për futjen në përdorim të mësimdhënies në gjuhën turke.

2.2. Mësimdhënësit, trajnimi i mësimdhënësve dhe menaxhimi i shkollave

Nën legjislacionin e aplikueshëm, autoritetet janë të obliguara që të sigurojnë se ka në dispozicion kuadër të kualifikuar për trajnimin e kandidatëve që kërkojnë të bëhen mësimdhënës të gjuhëve të komunitetit. Trajnimi duhet të kryhet në gjuhët e komunitetit dhe përzgjedhja e kandidatëve të përshtatshëm duhet të marrë parasysh nevojën për të pasur shkollim në gjuhët e komunitetit të ofruar nga folës të kualifikuar të asaj gjuhe, ku preferohen folës në gjuhë amtare. Veç kësaj, Ministria e Arsimit dhe komunat janë të obliguara që të sigurojnë se kryesuesit dhe mësimdhënësit e institucioneve publike arsimore që veprojnë në gjuhë të komuniteteve janë kryesisht përfaqësues të këtyre komuniteteve apo kanë njohuri me identitetin e komunitetit relevant.²⁷

Në praktikë, si në shkolla me planprograme kosovare ashtu në ato serbe, ka mungesë përfaqësimit të komuniteteve joshumicë në pozita menaxheriale në shkolla. Sistemi arsimor i Kosovës siguron trajnime në gjuhën amtare për mësimdhënësit turk dhe boshnjakë në një masë të caktuar, por trajnimi në lëndët e specializuara është në dispozicion vetëm në shqip. Shkollimi universitar në gjuhën serbe është në dispozicion në Mitrovicë/Mitrovica por nxënësit me diploma kosovare kanë vështirësi të regjistrohen. Qasja në trajnimin profesional zhvillimor është e vështirë për mësimdhënësit e planprogramit serb, meqë ai ofrohet jashtë Kosovës. Nuk është ofruar trajnimi specifik në gjuhën e tyre për mësimdhënësit e gjuhës rome. Ekziston një numër i konsiderueshëm i mësimdhënësve të nën-kualifikuar në sistemin e planprogramit kosovar. Numri i mësimdhënësve turq dhe boshnjakë është i pamjaftueshëm në disa komuna atyre i ofrohet trajnimi zhvillimor profesional përmes përkthimit simultan, cilësia e të cilit disa herë është e dobët.

Shkollimi i lartë për mësimdhënësit

Qasja në shkollim të lartë është e domosdoshme për të mundësuar trajnimin e një numri të mjaftueshëm të mësimdhënësve të kualifikuar nga të gjitha komunitetet. Legjislacioni në fuqi ofron qasje të barabartë në shkollim universitar, përfshirë atë përmes masave speciale për të siguruar pranimin e kandidatëve të të gjitha komuniteteve. Qeveria është përgjegjëse për të siguruar se mbahen mundësitë ekzistuese për trajnim profesional dhe shkollim të lartë në gjuhë të komuniteteve. Duke u bazuar në legjislacionin e aplikuar, programet shtesë të shkollimit të lartë të trajnimit në gjuhë të komuniteteve duhet të ofrohen në pajtim me nevojat e shprehura dhe zbatueshmërinë financiare.²⁸ Në praktikë, megjithatë, në Kosovë ka numër të

²⁶ Klasa parashkolllore në gjuhën turke, po ashtu, nuk vepron prej 2007/8 për shkak të mungesës së kërkesës.

²⁷ Nenet. 8.8 dhe 8.9, 2008 Ligji mbi të drejtat e komuniteteve.

²⁸ Nenet. 8.3 dhe 8.11, 2008 Ligji mbi të drejtat e komuniteteve.

kufizuar të mundësive të shkollimit të lartë në gjuhë jozyrtare,²⁹ dhe pengesat në qasje në shkollimin e lartë në gjuhën serbe janë shfaqur pas 17 shkurtit 2008.³⁰ Nxënësit e komuniteteve joshumicë shpeshherë migrojnë³¹ për të kërkuar mundësi të shkollimit të lartë. Me rastin e kthimit të tyre, këta nxënës shpesh përballen me mekanizma që marrin kohë dhe të shtrenjtë për njohjen e kualifikimeve të jashtme, duke përfshirë këtu edhe një provim në Universitetin e Prishtinës³². Studentët e komunitetit turk të cilët kanë marrë tituj universitarë, ekuivalenti i të cilëve nuk mund të merret në Kosovë, kanë pasur probleme për t'i nostrifikuar këta tituj. Zbatimi i një udhëzimi administrativ mbi parimet dhe procedurat e njohjes së titujve universitar që janë marrë jashtë Kosovës³³ mund ta sjellë një zgjidhje të kësaj situatë. Vendet e rezervuara për mësim në gjuhën shqipe janë në dispozicion në Universitetin e Prishtinës vetëm për komunitete të caktuara³⁴ dhe nuk ofrohet ndonjë ndihmë shtesë në lidhje me gjuhën (p.sh. përmes kurseve shtesë të gjuhës shqipe) për të garantuar rezultate të suksesshme akademike.

Shkollat me planprogram të Serbisë

Shumica e prindërve, mësimdhënësve dhe drejtorëve të shkollave pajtohen që prapavija dhe kualifikimet e përgjithshme akademike të mësimdhënësve sipas planprogramit të Serbisë janë të kënaqshme, edhe pse ka raste të mësimdhënësve pa tituj adekuatë, për shkak të mungesës së kandidatëve me tituj universitarë.³⁵ Derisa aftësimi i rregullt profesional, i rekomanduar nga Ministria e Arsimit e Serbisë, ofrohet në Serbi, shumica e mësimdhënësve nuk mund ta përballojnë financiarisht pjesëmarrjen në të, posaçërisht nëse duhet paguar ndonjë tarifë shkollore dhe nuk janë

²⁹ Universiteti i Prishtinës ofron disa lëndë në boshnjakisht dhe turqisht në filologji turke (50 vende), gjuhë boshnjake dhe turke për mësimdhënës (35 vende secili), Teknologji Informative (në boshnjakisht, 35 vende) dhe Administrim biznesi (në boshnjakisht, 80 vende).

³⁰ Shkollimi i lartë në serbisht është në dispozicion në Universitetin e Mitrovicë. Megjithatë, diplomat e shkollës së mesme të lëshuara nga autoritetet kosovare pas 17 shkurtit 2008 nuk pranohen nga ky universitet dhe nga universitetet tjera publike në Serbi. Nxënësit boshnjakë që dëshirojnë të vijnë në shkollimin e lartë në gjuhën serbe nuk kanë mundur të regjistrohen deri në dhjetor 2008, kur Ministria e arsimit lejoi komunën e Prizrenit që të lëshojë diplomat me vulë të UNMIK-ut. Është e duhur një zgjidhje e qëndrueshme për t'i shmangur këto pengesa në të ardhmen.

³¹ Kjo nuk vlen vetëm turqit, boshnjakët, goranët, romët dhe kroatët, por edhe për nxënësit shqiptarë dhe serbë. Nxënësit turq kanë përparësi në sigurimin e bursave të shkollimit të lartë të siguruar nga qeveria Turke (të hapura edhe për kandidatët e komuniteteve tjera). Së paku 300 nxënës turq janë aktualisht të regjistruar në universitete Turke, duke iu falënderuar këtyre bursave.

³² Kjo është e ashtuquajtura procedura e "nostrifikimit". Megjithatë, në pajtim me Konventën e Lisbonës për njohjen e kualifikimeve në lidhje me shkollimin e lartë në rajonin e Evropës (1997, CETS, Nr. 165), mund të zbatohen procedura dhe metoda më të harmonizuara dhe thjeshtuara të "njohjes".

³³ Udhëzimi Administrativ Nr. 39/2008, Ministria e Arsimit

³⁴ Në 2008/9, Universiteti i Prishtinës i rezervoi 134 vende për mësim në gjuhën shqipe për kandidatët e komuniteteve turq, boshnjak, romë, ashkali dhe egjiptian. Fjalja përjashtuese sipas së cilës "kandidatët jo-kosovarë dhe minoritarë kanë të drejtë që të konkurrojnë dhe të pranohen vetëm në kuotat e parapara për ta", si dhe kërkesa për një deklaratë të një organizate përfaqësuese të komunitetit si dëshmi për përkatësinë në atë komunitet, janë shqetësuese. Nuk ekziston ndonjë mundësi e vetë-identifikimit, derisa organizatat përfaqësuese të komunitetit kanë fuqi të njëanshme të certifikimit. Kurrfarë kriteresh objektive, siç janë gjuha e mësimi gjatë shkollimit të mëparshëm apo testi i gjuhës në gjuhën e komunitetit, nuk zbatohen. Vendet e rezervuara përbëjnë vetëm 1.5 për qind nga 8,970 vende të hapura për regjistrim. Burimi: Konkursi për regjistrimin e studentëve në vitin e parë të studimeve, për vitin akademik 2008-2009, faqe 1, 4, 8, 9 dhe 12.

³⁵ Në shkollën sipas planprogramit të Serbisë, në Janjevë 18 nga 20 mësimdhënës kanë të përfunduar [vetëm] diploma të shkollës së mesme.

të mbuluar transporti dhe vendosja. Fakti që shumica prej atyre që e kanë përfunduar shkollën e mesme regjistrohen për shkollim më të lartë jashtë Kosovës konsiderohet si një tregues i kualitetit të mësimdhënies. Pjesëtarët e komunitetit boshnjak në Mitrovicë janë të brengosur rreth ruajtjes së identitetit të tyre kulturo dhe fetar nën planprogramin e Serbisë dhe kërkojnë aftësim dhe mirëkuptim të shtuar të mësimdhënësve dhe menaxhimit të shkollës në pajtim me veçoritë e kulturës së tyre. Studentët e komunitetit boshnjak dhe goran që dëshirojnë të bëhen mësimdhënës mund ta vijojnë shkollimin e lartë në Pejë dhe Prizren, ku degët lokale të Universitetit të Prishtinës ofrojnë ligjërata universitare në gjuhën boshnjake.

Ka vetëm disa mësimdhënës në gjuhën romë në shkollat sipas planprogramit të Serbisë në Mitrovica/Mitrovicë, Ugljare/Uglar (Fushë Kosovë/Kosovo Polje), Janjevë/Janjevo (Lipjan/Lipljan), Gjilan/Gnjilane dhe Kamenicë/Kamenica dhe nuk është i mundshëm kurrfarë aftësimi specifik për gjuhën e tyre apo lëndën mësimore. Fakti që shumica e nxënësve romë në rajonin e Gjilanit/Gnjilane kryejnë vetëm shkollimin fillor (qoftë në gjuhën shqipe apo serbe) apo e braktisin shkollimin para se ta kenë kryer atë paraqet një pengesë për aftësimin e mësimdhënësve të kualifikuar në gjuhën romë. Studentët e komunitetit rom që dëshirojnë të marrin tituj të shkollimit të lartë shpesh nuk mund t'i mbulojnë shpenzimet përkatëse apo varen nga bursat e shkollimit, dhe shpesh regjistrohen në universitetet e Serbisë apo Ish Republikën Jugosllave të Maqedonisë për arsye të njohjes më të mirë të gjuhës së mësimin. Për më tepër, mësimdhënësit e punësuar të komunitetit rom nuk përfitojnë nga shumë mundësi të aftësimin brenda shërbimit të tyre pasi që aftësimet e tilla nuk ofrohen në Kosovë në gjuhën romë dhe është jashtëzakonisht e vështirë për ta që të marrin pjesë në aftësimet në gjuhën romë që i ofron Ministria e Arsimit e Serbisë.

Shkollat me planprogram të Kosovës

Në vitin 2008, prindërit shqiptarë Zvečan/Zveçan dhe Leposavić/Leposaviq u ankuan për kualitetin e shkollimit dhe teknikat e tejkaluara pedagogjike të mësimdhënësve në shkollën me planprogram të Kosovës në Boletin/Boljetin. Këta nxënës kanë në përgjithësi rezultate më të ulëta dhe shpesh e braktisin shkollimin e mesëm në pjesën jugore të Mitrovicë/Mitrovica. Derisa autoritetet komunale në veri të lumit Ibër/Ibar nuk e përkrahin shkollimin sipas planprogramit të Kosovës, Ministria e Arsimit gjithashtu dështoi për të ofruar aftësim pedagogjik për mësimdhënësit në gjuhën shqipe në shkollat në veri me planprogram të Kosovës. Në vitin 2008, aftësimi i ofruar nga Qendra Arsimore e Kosovës dhe i financuar nga OSBE-ja, solli përmirësime të dukshme në teknikat pedagogjike dhe standardet arsimore.

Në rajoni e Gjilanit/Gnjilane, autoritetet komunale dhe drejtuesit e shkollave e theksojnë shpesh mungesën e mësimdhënësve të kualifikuar në gjuhën e tyre amtare dhe numrin e vogël të studentëve të komuniteteve joshumicë si arsye për mungesë të shkollimit në gjuhët jozyrtare.³⁶ Mirëpo, mungesa e mësimdhënësve të kualifikuar në gjuhën e tyre amtare është një pengesë shumë e madhe edhe në komunat ku ofrohet shkollimi në gjuhë jozyrtare.

³⁶ Në Ferizaj/Uroševac, Novobërdë/Novo Brdo, Štrpce/Shtërpçë and Viti/Vitina nuk ofrohen shkollimi apo orë mësimi javore në ndonjë gjuhë jozyrtare. Nxënësit e komunitetit rom ndjekin planprogramin e Serbisë në të gjitha komunat, me përjashtim të Ferizajt dhe disa nxënësve në Kamenicë.

Shkollat me planprogram të Kosovës në Mitrovicë nuk kanë numër të mjaftueshëm të mësimit në gjuhë amtare e kanë gjuhën boshnjake. Mësimi në këtë gjuhë ofrohet nga mësimit shqiptarë që kanë njohuri të mjaftueshme të saj, kurse paralelet organizohen edhe nëse numri i nxënësve është nën minimumin e kërkuar.³⁷ Mungesa e mësimit të kualifikuar e krijon një nevojë serioze për aftësim dhe përmirësim të shkollësive arsimore në të gjitha gjuhët. Në shkollën e mesme ekonomike në rajonin e Pejës/Peć, 80 nga 1600 nxënës janë të komunitetit boshnjak. Atje ka 13 mësimit të kualifikuar të komunitetit boshnjak, mirëpo asnjë nga ata nuk jep mësim në lëndët kombëtare pasi që ato nuk bëjnë pjesë në fushën e tyre të ekspertizës. Kjo sjell deri te mungesa e mësimit të lëndëve kombëtare që janë të veçanta për një komunitet. Në Prizren, mësimit të komuniteteve boshnjak, ashkali dhe egjiptian marrin pjesë në aftësimet që i përkrah Ministria e Arsimit. Aftësimi zhvillohet në gjuhën shqipe ose boshnjake dhe ofrohet përkthimi. Mësimit nuk janë të kënaqur me nivelin e përkthimit.

Aftësimi për mësimit të komunitetit turk sponsorizohet nga Ministria e Arsimit dhe qeveria e Turqisë dhe zhvillohet në gjuhën shqipe, duke ofruar edhe përkthim simultan në gjuhën turke. Mësimit të theksojnë që aftësimi do të përmirësohet po të zhvillohet drejtpërdrejt në gjuhën turke. Përafërsisht 90 për qind e mësimit të komunitetit turk kanë kualifikime adekuate akademike. Në rajonin e Gjilanit, numri i tyre nuk është i mjaftueshëm për t'i mbuluar të gjitha klasat, paralelet dhe lëndët, prandaj ka mësimit që japin mësim në më shumë se një lëndë – edhe pse nuk janë të kualifikuar për këtë – apo mësimit që nuk kanë kualifikime të mjaftueshme as për të dhënë mësim. Nxënës të dëshirojnë të bëhen mësimit në gjuhën turke regjistruar në fakultetin e mësimit në Prizren, Fakultetin e gjuhës turke në Prishtinë, ose në Turqi. Mësimit të komunitetit turk në rajonin e Mitrovicës/Mitrovica ofrojnë mësim në gjuhën shqipe.

Në Obiliq/Obilić, shkolla në strehimoren e përkohshme të komunitetit në Plemetin/Plementina ofron planprogramin e Kosovës në gjuhën shqipe për fëmijët e komunitetit ashkali, egjiptian dhe rom. Derisa tre mësimit të komunitetit ashkali dhe një i komunitetit rom nuk kanë kualifikimet e nevojshme profesionale, as Ministria e Arsimit, as komuna nuk u kanë ofruar qasje në aftësim profesional. Në shkollat në Shtime, ka përafërsisht 150 nxënës të komunitetit ashkali mirëpo është vetëm një mësimit i këtij komuniteti.

Në të dy sistemet e shkollimit Kosovar dhe Serb, pozitat drejtuese në shkolla kryesisht mbahen nga përfaqësuesit e komunitetit përkatës shumicë. Romët, ashkalitë dhe egjiptianët nuk janë të përfaqësuar më masë të mjaftueshme në mesin e mësimit të kursit në nivelin drejtues të shkollave pothuajse mungojnë në tërësi. Komunitetit boshnjak dhe turk i mungon përfaqësimi në pozitat drejtuese në shkollat shumëgjuhëshe³⁸, por mbajnë pozita drejtuese në shkolla ku mësohet në gjuhët

³⁷ Neni 2 i Udhëzimit Administrativ Nr. 16/2002 të Ministrisë së Arsimit mbi përcaktimin e raportit mësues-nxënës, thekson që kufiri më i ulët i lejuar për një paralele në arsimin fillor dhe të mesëm është 21 nxënës. Ky numër ulet në 15 nxënës për një mësues për shkollimin në ndonjë nga gjuhët jozyrtare.

³⁸ Në Prizren, vetëm një nga gjashtë shkollat fillore ku mësohet edhe në gjuhën turke (Motrat Qiriazit) e ka një zëvendës-drejtor të komunitetit turk. Asnjë nga katër shkollat e mesme ku mësohet edhe në gjuhën turke nuk ka ndonjë pozitë drejtuese për pjesëtarët e komunitetit turk. Në shkollën në Zllapek/Zlopek (Pejë/Peć), ku shumica e nxënësve dhe mësimit të komunitetit boshnjak, koordinatori është shqiptar. Mësimit të komunitetit boshnjak të shkollave fillore në

jozyrtare.³⁹ Drejtorët kosovar kroatë dhe kosovar shqiptarë të emëruar nga komuna punojnë së bashku nën një drejtor të komunitetit serb në të njëjtën shkollë me planprogram të Serbisë në Janjevë/Janjevo.⁴⁰

2.3. Themelimi i institucioneve private arsimore

Ligji i aplikueshëm në Kosovë, njeh të drejtën e komuniteteve për të themeluar institucione private për shkollim dhe trajnim, për të kërkuar fonde publike, dhe për të aplikuar për akreditim nga Ministria e Arsimit.⁴¹ Momentalisht, të vetmet institucione private arsimore që ofrojnë shkollim në gjuhën dhe kulturën e komuniteteve joshumicë gjenden në Prishtinë/Priština and Štrpce/Shtërpçë. Ndërhyrjet nga ana e Ministrisë së Arsimit janë të kufizuara vetëm në përcaktimin e rregullave të njohjes dhe licencimit⁴², pa ofruar përkrahje financiare apo tjetër.

Iniciativat momentale janë të kufizuara vetëm në projekte të organizatave joqeveritare (OJQ) vendore dhe ndërkombëtare dhe aktivitete arsimore jashtë programit mësimor, zakonisht për fëmijët në shkollat fillore. Komuniteti turk në Kosovë e gëzon një përparësi të konsiderueshme për shkak të përkrahjes nga ana e qeverisë së Turqisë.

Në Prishtinë/Priština, Qendra arsimore “Gulistan”⁴³ ofron shkollim në nivel fillor dhe të mesëm në gjuhën angleze, turke dhe shqipe. Në Shtërpçë, një universitet privat nga Novi Sadi, përkatësisht Fakulteti i biznesit (Fakultet za Usluzni Biznis), ofron ligjërata na gjuhën serbe.⁴⁴ Në veri të Mitrovicës/Mitrovica, një shoqëri kulturore-artistike e komunitetit boshnjak ndali aktivitetet për shkak të mungesës së fondeve. Ajo u kishte ndihmuar nxënësve të këtij komuniteti që ta ruajnë kulturën dhe larminë e tyre historike në një mënyrë që nuk e ofron asnjë nga sistemet arsimore.

Në rajonin e Gjilanit/Gnjilane, nxënësit e komuniteti ashkali kanë nganjëherë qasje në orët plotësuese mësimore që i organizojnë OJQ-të për ta përkrahur integrimin në shkollat fillore dhe të mesme. Në Mitrovicë/Mitrovica dhe Vushtrri/Vučitrn, iniciativa të shoqërive civile ofrojnë aktivitete jashtë programit të shkollës mbi gjuhën, historinë, kulturën, muzikën dhe vallen turke për nxënësit e komunitetit turk. Në veri të Mitrovicës/ Mitrovica dhe në Leposaviq/Leposavić, OJQ-të “Caritas” dhe “Padem” kanë nisur paralele në nivel parashkollor, si dhe orë mësimore shpesh të gjuhës rome

Prapaqan/Prapaćane (Deçan/Dećane) dhe Dobrushë/Dobruša (Istog/Istok) janë të pakënaqur me përfaqësim të pamjaftueshëm.

³⁹ Në shkollat një-etnike në gjuhën boshnjake në luginën e Župa/Zhupë (Prizren) dhe në Vitomiricë/Vitomirica (Pejë/Peć) mësimdhënësit dhe drejtorët i takojnë komunitetit boshnjak. Drejtorët e shkollave fillore dhe të mesme në Mamushë/Mamuša janë të komunitetit turk. Edhe pse janë emëruar nga komuna, drejtorët e shkollave në Restelica/Restelicë, Brod/Brod and Rapča/Rapqë (Dragash/Dragaš), ku shumica ose të gjithë nxënësit mësojnë sipas planprogramit të Serbisë, janë të gjithë nga fshatrat përkatëse dhe e kanë të njohur me identitetin e komunitetit.

⁴⁰ Shkolla ka tre emra: “Vladimir Nator”; “Janjevo”; dhe “Shtëpjen Gjeçovi”.

⁴¹ Neni 22, Ligji për përdorimin e gjuhëve; Neni 8.4, 2008, Ligji për të drejtat e komuniteteve

⁴² Udhëzimi administrativ Nr. 3/2003 i Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë për licencimin dhe regjistrimin e institucioneve arsimore private të nivelit fillor dhe të mesëm në Kosovë, respektivisht Udhëzimi administrativ Nr. 24/2003 për licencimin e institucioneve arsimore private të nivelit të lartë në Kosovë

⁴³ Institucion privat arsimor që drejtohet bashkërisht nga Shkolla ndërkombëtare në Prishtinë dhe Kolegji “Mehmet Akif”: paralele/lëndë të përziera që e integrojnë planprogramin e Kosovës dhe Republikës së Turqisë.

⁴⁴ Qendra është e licencuar nga Ministria e Arsimit e Serbisë.

dhe serbe për fëmijët e komunitetit rom. Në Fushë-Kosovë/Kosovo Polje,, OJQ “Balkan Sunflowers” dhe “Qendra për bashkëpunim dhe integrim” janë duke e realizuar projektin “Qendra e mësimi” për diku rreth 350 nxënës të komunitetit ashkali dhe egjiptian.⁴⁵ Në Podujevë/Podujevo, Care International promovon integrimin në shkollë për nxënësit e komunitetit ashkali, rom dhe shqiptar përmes projekteve të përbashkëta.⁴⁶ Në Graçanicë/ Gračanica, “Balkan Sunflowers” e drejton një qendër arsimit të nivelit parashkollor për fëmijët e komunitetit rom, kurse në Shtime/ Štimlje, kjo OJQ është duke e realizuar projektin “Detyrat e shtëpisë pas shkollës” që ka të bëjë me përafërsisht 100 nxënës të komunitetit ashkali prej moshës parashkollore e deri në moshën e klasës së pestë. Prej vitit 2002, OJQ “Bethany Christian Services” ka ofruar shkollim shtesë për 170 nxënës të komunitetit rom, ashkali dhe egjiptian të moshës parashkollore dhe të shkollës fillore në vendbanimin joformal “Kolonja” në (Gjakovë/ Đakovica).

2.4. Zgjidhjet alternative

Nëse shkollimi në gjuhën e zgjedhur zyrtare ose në gjuhën amtare të komunitetit nuk është në dispozicion, legjislacioni në fuqi në Kosovë kërkon nga komunat ose nga qeveria që të ofrojë alternativa, përfshirë këtu transportin e subvencionuar deri në zonat ku ofrohet shkollim i tillë, shkollimin në distancë, aranzhimet e ndryshme për mësimdhënie të lëvizshme, apo edhe ofertat për qëndrim në konvikt.⁴⁷ Në realitet, në ato vende ku nuk është në dispozicion shkollimi në gjuhën amtare, alternativat e ofruara kufizohen vetëm në ofrimin e transportit. Megjithatë, komunat në veri të Kosovës me shumicë serbe nuk ofrojnë transportimin e nxënësve shqiptarë. Në vitin 2009, ndërtimi i më shumë shkollave në sistemin sipas planprogramit të Kosovës nuk u ka dhënë prioritet të mjaftueshëm komuniteteve joshumicë. Në mungesë të masave dhe udhëzimeve konkrete në nivelin qendror, iniciativa aktive për integrimin e nxënësve të cenusur të komunitetit rom, ashkali dhe egjiptian ka vetëm në disa komuna. Ndikimi i bursave të shkollimit që janë në dispozicion për nxënësit e këtyre komuniteteve duhet të shqyrtohet edhe më tutje, posaçërisht pasi që i referohet përfundimit të shkollimit fillor dhe të mesëm edhe qasjes në shkollimin e lartë.

Aranzhimet e transportit

Shumica e Serbeve Kosovar në komunat e Zvečan/Zveçan, Zubin Potok, dhe Leposavić/Leposaviq nuk organizojnë transport për nxënësit shqiptarë që udhëtojnë në pjesën jugore të Mitrovicës/Mitrovica për të vijuar mësimin në shkollat e mesme në gjuhën shqipe. Transporti ofrohet ose me anë të autobusëve privatë (të financuar nga donatorë privatë ose të jashtëm), ose përmes linjave humanitare të autobusëve të Ministrisë së Transportit dhe Telekomunikacionit të Kosovës. Në Leposavić/Leposaviq është një autobus privat që momentalisht financohet me një

⁴⁵ Projekti filloi në mars të vitit 2008 dhe ka të bëjë me ndihmën për nxënësit e komunitetit ashkali dhe egjiptian për t’i kryer detyrat e shtëpisë.

⁴⁶ “Detyrat e shtëpisë pas shkollës” (nxënësit e klasës 1-5) dhe “Stop analfabetizmit” (shkollimi i femrave)

⁴⁷ Neni 19.4, Ligji për përdorimin e gjuhëve; Neni 8.2, 2008, Ligji për të drejtat e komuniteteve. Mësimdhënësit e lëvizshëm janë mësimdhënësit të cilët do të udhëtonin dhe do të ofronin shkollim në gjuhën amtare për grupe të vogla të nxënësve që jetojnë në vende të ndryshme. Ofertat për qëndrim në konvikt do të garantonin që një fëmijë, për të cilin nuk është në dispozicion shkollimi në gjuhën amtare në komunën e origjinës, do të mund ta vijonte shkollimin e tillë në një vend tjetër, ku qeveria e Kosovës apo komuna e origjinës do t’i mbulonin shpenzimet e qëndrimit.

donacion privat kurse prindërit paguajnë për transportin. Fëmijët shqiptarë që jetojnë në pjesën veriore të Mitrovicës/Mitrovica transportohen privatisht ose ecin në këmbë deri në pjesën jugore të Mitrovicës/Mitrovica. Momentalisht, për nxënësit shqiptarë nga enklava Kodra e Minatorëve/Mikronaselje (në veri të Mitrovica/ Mitrovicës) nuk konsiderohet e sigurt që të kalojnë këtë rrugë në këmbë për shkak se duhet të kalojnë nëpër zonat e banuara me serbë. Si rrjedhim, fëmijët që u takojnë atyre familjeve që nuk kanë mundësi financiare që t'i mbulojnë shpenzimet e transportit shkollohen në një shkollë të përkohshme në një kontejner, ku mungojnë kushtet elementare logjistike. Drejtori i arsimit i komunës refuzon të organizojë transportin⁴⁸ për këta fëmijë deri sa të mos jene gjetur lokalet adekuate arsimore për shkak se, sipas mendimit të tij, kjo iniciativë do të ishte në kundërshtim me cakun e integritimit ndëretnik në qytetin e ndarë.

Për nxënësit e komunitetit boshnjak, shkollimi i mesëm shpesh herë nënkupton shpenzime udhëtimi dhe transporti⁴⁹ që nuk mbulohen nga komunat përkatëse. Në Podujevë, nxënësit që jetojnë në zonat e largëta nuk kanë qasje në transportin e nxënësve. Komunat e Vushtrri/Vuçitrit⁵⁰, Fushë Kosovë/Kosovo Polje⁵¹ dhe Lipjan/Lipljan⁵² ofrojnë transport falas për nxënësit e komunitetit serb dhe rom që e vijnë mësimin me planprogram të Serbisë. Si masë kundër braktisjes së shkollimit nga ana e nxënësve të komunitetit ashkali, komuna e Lipjan/Lipljan i financon orët mësimore plotësuese dhe ofron transportin e nxënësve. Komuna e Gjilan/Gnjilane gjithashtu e lehtëson transportin e fëmijëve të komunitetit rom prej lagjes “Abdullah Presheva” deri në lagjen “Ivo Lolla Ribar”, ku gjendet shkolla “Vuk Karadzic” me planprogram të Serbisë që ofron mësim edhe në gjuhën rome. Komuna gjithashtu paguan qiranë për lokalet e shkollës, që gjendet në një shtëpi private. Si krahasim, komunat tjera në këtë rajon, ku nuk është mundësuar shkollimi në gjuhët jo-zyrtare⁵³, nuk kanë ndërmarrë asnjë hap për të siguruar zgjidhje alternative

Studentët turq në Mitrovicë/Mitrovica arsimohen në gjuhën shqipe por drejtori komunal i arsimit është i gatshëm që të organizojë orë mësimi në gjuhën turke nëse një gjë e tillë kërkohet. Në Vushtrri/Vuçitrit, përfaqësuesit turk në Kuvendin Komunal së voni kanë kërkuar transportim me autobus për t'ua mundësuar nxënësve turq

⁴⁸ Neni 22 i Ligjit për arsimin fillor dhe të mesëm i obligon komunat që të organizojnë transportin për nxënësit që e ndjekin shkollimin e arsimit të detyrueshëm brenda territorit të tyre. Komuna mund të organizojë, si dhe të kërkojë pagesë për transport nga nxënësit e shkollave të mesme të larta, përkatësisht nxënësit që ndjekin shkollimin e padetyrueshëm.

⁴⁹ Për shembull, në Prapaqan/Prapaçane (Deçan/Deçane), një familje e komunitetit boshnjak që varet nga ndihma sociale paguan 50 euro në muaj për transportin e dy fëmijëve deri te shkolla më e afërt e mesme në gjuhën boshnjake në Pejë, pasi që ata nuk kanë në dispozicion shkollimin në gjuhën boshnjake në Deçan/ Deçane.

⁵⁰ Fëmijët serbë nga Gojbulja/Gojbulë, Grace/Gracë and Banjskë/Banjska që vijnë mësimin e mesëm në Priluzje/Prelluzhë ose në pjesën veriore të Mitrovica/Mitrovicë. Ata gjithashtu shfrytëzojnë linjat humanitare të autobusëve që i ofron Ministria e Transportit dhe Telekomunikacionit.

⁵¹ Nxënësit serbë dhe romë që vijnë mësimin në shkollën “Sveti Sava” me planprogram të Serbisë, në Bresje.

⁵² Nxënësit e komunitetit kroat, romë, boshnjak dhe serb që vijnë mësimin në shkollat e mesme me planprogram të Serbisë në Suvi Do/Suhodoll, Donja Gušterica/Guštericë e Ulët, Laplje Selo/Llapllasellë dhe Gračanica/Graçanicë. Komuna ofron dy minibusë dhe i mbulon shpenzimet e mirëmbajtjes së automjeteve, kurse prindërit e paguajnë rogen e vozitësit.

⁵³ Shkollimi në gjuhën rome dhe boshnjake nuk është mundësuar në Ferizaj/Uroševac ku jetojnë boshnjakët goranët dhe romët, dhe në gjuhën rome në Novobërdë/Novo Brdo, Štrpce/Shtërpçë, dhe Viti/Vitina.

vijimin në shkollën e mesme në gjuhën turke në Prishtinë/Priština, duke filluar nga viti i ardhshëm shkollor.

Ndërtimi i shkollave të reja

Në tërë Kosovën, asimetria ndërmjet numrit në rritje e sipër të nxënësve dhe hapësirave të pamjaftueshme shkollore, kombinuar me teste të pranimit, kanë si pasojë raste të shumta të përjashtimit nga shkollimi i mesëm⁵⁴ që gjithashtu kanë ndikim tek komunitetet joshumicë, përfshirë komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian.⁵⁵ Në këtë kontekst, testi i pranimit mund të ketë për pasojë në përjashtim të gabuar nga shkollimi i mesëm në vend të orientimit të nxënësve drejt drejtimit më të përshtatshëm të shkollimit të mesëm. Standardet ndërkombëtare për të drejtën në arsim qartësojnë që shkollimi i mesëm duhet të “vihet në dispozicion në përgjithësi” pavarësisht nga kapaciteti ose aftësia e dukshme e studentit.⁵⁶ Edhe kur studentët pranohen, komunitat në përgjithësi rrisin numrin maksimal të nxënësve për klasë, gjë që rezultojnë në mbipopullim të klasave, dhe cilësi më të ulët të shkollimit.⁵⁷ Kjo gjendje e ka përshpejtuar procesin e ndarjes së € 27.260.000 për ndërtim të shkollave të reja në vitin 2009. Vetëm dy nga shkollat e reja të planifikuara janë për komunitetet joshumicë, me një investim prej € 234, 000, apo 0.9 për qind të këtij fondi.⁵⁸

Masat për integrimin e fëmijëve të komuniteteve rom, ashkali, dhe egjiptian.

Pas një programi të shkollimit të përshpejtuar në 2004-2007 me fokus në 1,800 fëmijë romë, ashkali dhe egjiptian në nëntë komuna,⁵⁹ nevoja për masa të qëndrueshme për të siguruar integrimin në fushën e arsimit të nxënësve romë, ashkali dhe egjiptian u identifikua në strategjinë shumë-vjeçare të ministrisë së arsimit.⁶⁰

Në Prizren dhe Gjakovë/Đakovica, ku nxënësit romë, ashkali dhe egjiptianë e posaçërisht, femrat janë të prekura nga shkalla e lartë e braktisjes dhe numrit të ulët të regjistrimit, kryesisht për shkak të gjendjes së vështirë ekonomike, komunitat kanë organizuar fushata publike të ngritjes së vetëdijes duke i inkurajuar prindërit e tyre për regjistrimin e fëmijëve të tyre nëpër shkolla.

⁵⁴ Në gusht të vitit 2008, 240 nga 698 studentë nuk janë pranuar në arsimin e mesëm në Shtime/Štimlje, dhe 230 nga 582 në Fushë Kosovë/Kosovo Polje. Prioriteti bëhet në bazë të rezultateve të testit të Kosovës dhe notave të studentëve. Fëmijët e familjeve të goditura nga varfëria, posaçërisht ato romë, ashkali, dhe egjiptiane, kanë më së shumti gjasa që të kenë rezultat të dobët në testet e pranimit prandaj janë shumë të cenueshëm ndaj përjashtimit.

⁵⁵ Në shtator të vitit 2008, një student ashkali, nuk është pranuar në shkollën e mesme në Podujevë/Podijevo për shkak të rezultatit dhe është regjistruar më vonë pas intervenimit nga Ministria e Arsimit.

⁵⁶ Neni 13.2(b), Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore; Këshilli ekonomik Social, Komiteti për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore, E/C.12/1999/10, Koment i Përgjithshëm për të Drejtat në Arsim, 08/12/1999, paragrafi 13.

⁵⁷ Numri i nxënësve për një mësimdhënës është 32. Në Fushë Kosovë/Kosovo Polje është rritur në 37, dhe klasat në përgjithësi mund të mbajnë nga 45 nxënës. Në Shtime/Štimlje, pragu është rritur në 44.

⁵⁸ Ligji i aplikueshëm për Buxhetin e Kosovës për vitin 2009 (Nr. 03/l-105); Tabelat Buxhetore për vitin 2009; Pika specifike të buxhetit: ‘ndërtimi i shkollës fillore për pakicat,’ 200,000 Euro; dhe ‘ndërtimi i shkollës fillore në Bostan’ (Novobërdë/Novo Brdo), 34,000 Euro.

⁵⁹ Prishtinë/Priština, Lipjan/Lipljan, Suharekë/Suva Reka, Pejë/Peć, Istog/Istok, Prizren, Shtime/Štimlje, Gjakovë/Đakovica dhe Fushë Kosovë/Kosovo Polje.

⁶⁰ Strategjia për integrim të komuniteteve romë, ashkali dhe egjiptian në Kosovë – arsimit 2007-2017. Strategjia e qeverisë për integrim të komuniteteve romë, ashkali dhe egjiptian në Kosovë 2009-2015, gjithashtu përmban kapitull të veçantë mbi arsimin.

Drejtoria e arsimit në Komunën e Gjakovës/Đakovica i ka udhëzuar drejtorët e shkollave që të monitorojnë dhe dorëzojnë raporte të rregullta lidhur me vijimin e shkollës nga fëmijët që u përkasin komuniteteve joshumicë. Me qëllim të mbështetjes së integritetit të arsimit përmes qasjes së shtuar në shkollimin parashkollor, Karitasi Zviceran dhe komuna e Prizrenit së bashku kanë themeluar dy shkolla të reja të nivelit parashkollor ku në nëntor të vitit 2008 gjysma e punonjësve i përkisnin komunitetit rom. Vlen të theksohet që, prindërit romë kanë kërkuar që fëmijët e tyre të mësohen në gjuhën shqipe. Në Prizren dhe Ferizaj/Uroševac, Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim (UNDP) ka siguruar bursa për studentët romë, ashkali dhe egjiptianë që vijnë në shkollën e mesme dhe universitetin.⁶¹ Bursa tjera për të njëjtat komunitete janë shpërndarë edhe në vitin 2009 nga Ministria për Komunitete dhe Kthim të parapara nga Zyra për Komunitete pranë Zyrës së Kryeministrit.⁶²

Ndonëse komuniteti rom është posaçërisht i prekur nga braktisja e shkollës për shkak të kufizimeve ekonomike, traditave që posaçërisht prekin vajzat (si p.sh. martesat e hershme), përjashtimi, dhe furnizimi me ndërprerje me tekste shkollore, komunat në rajonin e Gjilanit/Gnjilane nuk kanë ndërmarrë veprime efektive lidhur me këtë. Masat kanë mundur të përfshijnë një qasje sistematike për të parandaluar braktisjen e shkollës, siç është organizimi i orëve plotësuese të veprimtarive mbështetëse për nxënësit që braktisin shkollën apo organizimi i fushatave të ngritjes së vetëdijes lidhur me rëndësinë e arsimit. Disa drejtorë të shkollave kanë mbajtur takime të rastit me prindërit e nxënësve që kanë braktisur shkollën. Tekstet shkollore për nxënësit romë nganjëherë sigurohen nga Ministria e Arsimit në Kosovë, apo ajo e Serbisë, varësisht nga planprogrami i mësimi, apo nga organizatat ndërkombëtare apo joqeveritare. Në disa shkolla në Pejë/Peć, Istog/Istok dhe Klinë/Klina, ose janë organizuar orë plotësuese për fëmijët romë, ashkali dhe egjiptianë ose është kërkuar nga prindërit që të organizohen ato.⁶³ Karitas Kosova në pjesën veriore të Mitrovica/Mitrovicë dhe në Padem në Leposavić/Leposaviq, ofrojnë arsimin plotësues për fëmijët romë në gjuhën serbe dhe rome. Në Osojan/Osojanë (Istog/Istok) dhe Pejë/Peć, ku mungesa e orëve në gjuhën rome dhe e arsimtarëve të kualifikuar romë përbënë pengesë të madhe, komuniteti rom është në rrezik të humbjes së gjuhës së tyre amtare. Në pritje të zhvillimit të lëndës së gjuhës rome brenda planprogramit Kosovar, disa prind romë i kanë sugjeruar ministrisë dhe komunave që të organizojnë trajnim profesional për rekrutimin e mësimitdhënësve me perspektive romë nga Ish Republika Jugosllave e Maqedonisë, ku gjuha rome është në përdorim më të gjerë.

3. NDARJA E SISTEMEVE TË ARSIMIT DHE PENGESAT NË PUNËN E SHKOLLAVE SHUMËETNIKE

Si në vendet me shumicë shqiptare ashtu edhe në ato serbe, sistemet e arsimit të Kosovës dhe Serbisë izolojnë studentët serbë dhe shqiptarë nga mjedisi social i

⁶¹ Deri më tani, UNDP në Projektin Rajonal për Romë ka financuar 26 bursa në Prizren (24 për nivelin e mesëm dhe 2 për nivelin universitar) dhe 13 në Ferizaj/Uroševac (10 për nivelin e mesëm dhe 3 për atë universitar).

⁶² Bursat e Ministrisë për Komunitete dhe Kthim (50 për nivelin e mesëm dhe 10 për atë universitar) i referohen periudhës janar-qershor 2009. Zyra për Komunitete planifikon themelimin e një fondi prej 100.000 Eurove për bursa të komuniteteve për të mbështetur së paku nga 10 studentë nga komunitetet për çdo vit.

⁶³ Shkolla fillore “Vaso Pash Shkodrani” në Pejë/Peć; një projekt nga OJQ-ja italiane “Avsi/Tavolo Trentino con il Kosovo”; kërkesa nga një OJQ egjiptiane “Vizioni 02” në komunën e Istog/Istok; dhe projekti për orët plotësuese i realizuar nga Care International në Klinë/Klina.

komunitetit shumicë, përderisa ato ofrojnë arsimim në gjuhën amtare. Në këtë mënyrë, arsimi krijon dhe përforcon ndarjen. Komunitete tjera gravitojnë përreth njërit nga sistemet e arsimit ose tjetrit, varësisht nga faktorët gjeografik, gjuhësor, dhe faktorë tjerë të identitetit. Varësisht nga sistemi i arsimit që vijohet, ekzistojnë shkolla shumetnike të përbëra qoftë nga nxënës shqiptarë apo serbë dhe komunitete tjera, por shkolla të kombinuara me nxënës shqiptarë dhe serbë janë më tepër përjashtim se sa rregull. Edhe në rastet e izoluara në të cilat nxënësit e këtyre komuniteteve vijnë në mësimin nën të njëjtin kulm, nuk ka fare ndërveprim ndërmjet nxënësve të komuniteteve shqiptare dhe serbe. Fakti që nxënësit serbë mësojnë vetëm gjuhën serbe dhe nxënësit shqiptarë mësojnë vetëm shqip edhe më tepër e parandalon komunikimin.

Derisa shkollat me planprogram të Kosovës më fëmijë shqiptarë dhe të komuniteteve joserbe⁶⁴ dhe shkollat me planprogram të Serbisë me fëmijë serbë dhe fëmijë nga komunitetet joshqiptarë⁶⁵ mund të gjenden në mbarë Kosovën, fëmijët shqiptarë dhe serbë nuk e vijnë në mësimin së bashku. Integrimi dhe ndërveprimi social i nxënësve që vijnë në sistemet e arsimit të Kosovës dhe Serbisë brenda të së njëjtës shkollë mbetet problematik. Shkolla 'Sveti Sava' në Bresje (Fushë Kosovë/Kosovo Polje) është një rast i tillë. Para ngjarjeve të marsit 2004, kjo shkollë ka pasur vetëm nxënës me planprogram të Serbisë. Në të njëjtën kohë, udhëheqësia komunale shqiptare dhe partitë politike kishin ngritur brenga lidhur me atë se shkolla nuk po shfrytëzohej në kapacitetin e saj të plotë, përderisa komuna kishte mungesë së hapësirës shkollore. Kjo shkollë u shkatërrua në mars të vitit 2004 dhe u rindërtua e u rihap në shtator të vitit 2004. Diskutimet pa ndonjë rezultat ndërmjet përfaqësuesve të serbëve dhe të shqiptarëve lidhur me përdorimin e përbashkët të shkollës çuan në një Vendim Ekzekutiv të Përfaqësuesit të Special të Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara, i cili e bëri atë shkollë shumetnike që përdoret në ndërrime të ndryshme të planprogramit të Serbisë dhe të Kosovës. Misioni i Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK) hapi një zyrë për të administruar dhe monitoruar shkollën. Në tetor të vitit 2008, zyra u mbyll dhe komuna mori përgjegjësi për implementimin e Vendimit Ekzekutiv. Që atëherë, një numër në zvogëlim e sipër i fëmijëve serbë dhe romë⁶⁶ dhe një numër në rritje e sipër i nxënësve shqiptarë dhe ashkali⁶⁷ vijnë në mësimin në kohë

⁶⁴ Shkollat në pjesën jugore të Mitrovicë/Mitrovica, Vushtrri/Vučitrn dhe Skenderaj/Srbica, kanë nxënës shqiptar, ashkali dhe boshnjak. Nxënësit turq dhe ata shqiptar vijnë në mësimin në gjuhën shqipe në Mitrovicë dhe Vushtrri. Boshnjakët dhe shqiptarët në rajonin e Pejës vijnë në mësimin në të njëjtat shkolla, ndonëse në orë të ndara gjuhësore. Në rajonin e Pejës/Peç, në Fushë-Kosovë/Kosovo Polje, Podujevë/Podujevo dhe Shtime/Štimlje, nxënësit romë, ashkali, egjiptian dhe shqiptar vijnë në mësimin në të njëjtat shkolla. Në Prishtinë/Priština, nxënësit turq, shqiptar dhe boshnjak ndajnë të njëjtat klasa apo shkolla. E vejta gjë vlen edhe për nxënësit boshnjak, turq, romë, ashkali, egjiptian dhe shqiptar në rajonin e Prizrenit, dhe për nxënësit shqiptar, turq, ashkali, goran, dhe boshnjak nëpër shkolla të ndryshme në rajonin e Gjilan/Gnjilane.

⁶⁵ Shkollat me planprogram të Serbisë në rajonet e Mitrovicës/Mitrovica dhe Gjilanit/Gnjilane, Osojan/Osojanë, Istog/Istok, Fushë-Kosovë/Kosovo Polje, Obiliq/Obilić dhe Gračanica/Gračanicë (Prishtinë/Priština) përbëhen nga nxënës serb dhe romë. Shkollat me planprogram të Serbisë gjithashtu vijnë edhe nga studentët boshnjak në pjesën veriore të Mitrovicës/Mitrovica dhe Leposavić/Leposaviq, dhe nga kroatët, boshnjakët dhe romët në Janjevo/Janjevë (Lipjan/Lipljan).

⁶⁶ Janë 62 nxënës të shkollës fillore në gjuhën serbe në katër klasa të katit të parë (mesatarisht nga 12 nxënës për një klasë). Pavarësisht nga numri i tyre, Vendimi Ekzekutiv i UNMIK-ut 2005/7 i mbron të drejtat e serbëve dhe nxënësve tjerë joshqiptar për vazhdimin e shkollimit në shkolla.

⁶⁷ Sipas Drejtorisë komunale për arsim, 383 nxënës vijnë në mësimin sipas planprogramit Kosovar të shkollës 'Selman Riza' në shatë klasë të katit të dytë, me një mesatare prej 54 nxënësve për një klasë. Përdorimi aktual i shkollës nuk e përjashton komunën nga obligimi për të ndërtuar një shkollë të re për të plotësuar nevojat e numrit në rritje e sipër të nxënësve.

të ndara në kate të ndara pa komunikim ndërmjet udhëheqësve të shkollës, arsimtarëve dhe nxënësve të dy sistemeve. Popullata serbe në zvogëlim e sipër ndjehet që shkollimi sipas planprogramit të Serbisë mund të jetë në rrezik.⁶⁸

Gjatë vitit shkollor 2008/2009, në qytetin e Dragashit/Dragaš, mësimdhënësit goran dhe shqiptarë nuk i ndanin hapësirat shkollore në dy shkolla që përdorshin nga dy komunitetet.⁶⁹ Në shtator të vitit 2008, një vendim i kryetarit të komunës ka parandaluar mësimdhënësit goranë që nuk kanë kontrata me autoritetet Kosovare që të hyjnë në ndërtesat shkollore. Që nga viti 2006, arsimtarët goranë kanë nënshkruar kontrata kryesisht me Ministrinë e Shëndetësisë së Serbisë.⁷⁰ Kjo situatë i ka privuar 135 fëmijë goranë nga shkollimi në gjuhën serbe. Që nga janari i vitit 2009, pas humbjes së një semestri të tërë, nxënësit dhe arsimtarët e shkollës fillore ‘Nezim Berati/Nebojša Jerković’ në Dragash/Dragaš nuk kishin alternativë tjetër përveç se të vendoseshin në paralelet e ndara në katër fshatra përreth. Mirëpo, supozohet që për shkak të mungesës së hapësirës dhe distancës ndërmjet fshatrave, organizimi i rregullt i shkollimit është penguar seriozisht. Për shembull, nxënësit e klasave 5-8 vijnë orë vetëm 30 minutëshe dy herë në javë. Pas vizitës së Komisionerit të Lartë të OSBE-së për Pakica Kombëtare në shkurt të vitit 2009, komuna, kryeministri dhe ministri i arsimit kanë premtuar që do të sigurojnë kthim të shpejtë të nxënësve dhe të mësimdhënësve goranë në shkollën përkatëse. Më 3 mars, studentët goranë të klasave 5-8 janë kthyer në shkollë kurse nxënësit e klasave 1-4 ende jo. Mirëpo më datën 17 mars mësimdhënësit dhe nxënësit e klasave 5-8 u tërhoqën nga shkolla, supozohet për shkak të ndërhyrjeve të drejtorit i cili punon me planprogram Kosovar pas ripranimit, dhe aktiviteteve të mësimdhënësve të cilët punojnë me planprogram të Serbisë.⁷¹

Shkolla e Poneš/Poneshit (Gjilan/Gnjilane) është një shembull tjetër që tregon se sa janë të ndikuara politikisht qëndrimet që e ndajnë komunitetin shqiptar dhe serb në Kosovë. Ndërtesa e shkollës është ndërtuar me mbështetjen financiare nga Ambasada Britanike për të dy komunitetet, për shkollim në gjuhën dhe planprogramin e tyre, por për të ndarë orët siç është edukata fizike. Mirëpo, vendosja e një shenje për emërimin e një shkolle me emrin e një pjesëtari të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës dhe një shenje “Republika e Kosovës” u treguan si elemente shumë ndarëse dhe në kundërshtim me frymën e projektit, i cili bënte përpjekje për afrimin e komuniteteve nën një kulm me

⁶⁸ Nxënësit serb vijnë nga fshatrat si Uglar/Ugljare, ku numri i popullatës serbe ka shënuar rënie të vazhdueshme që nga marsi i vitit 2004 dhe kanë mbetur vetëm dhjetë nga 80 familje sa ishin në fillim. Shitblerjet ndëretnike të pronës po vazhdojnë, kurse disa familje të reja shqiptare janë vendosur në fshat. Nxënësit romë në shkollë sipas disa raportimeve po e shqyrtojnë mundësinë e zgjedhjes së planprogramit Kosovar të arsimit.

⁶⁹ Studentët dhe mësimdhënësit goran nuk shfrytëzojnë shkollën e mesme të qytezës së Dragashit /Dragaš që nga vitit 2007, dhe nuk e kanë shfrytëzuar ‘Nezim Berati/ Nebojša Jerković’ që nga shtatori i vitit 2008.

⁷⁰ Përderisa planprogrami i Kosovës nuk është siguruar në gjuhën serbe, në vitin 2006 Qendra Koordinuese për Kosovë dhe Metohi e Serbisë kërkojë nga mësimdhënësit goran që të nënshkruajnë kontrata ose me Republikën e Serbisë apo me Kosovën. Që atëherë mësimdhënësit goran kanë refuzuar të nënshkruajnë kontrata me institucionet e Kosovës mbi këtë çështje. Mësimdhënësit e kontraktuar nga Republika e Serbisë në Kosovë gëzojnë paga dhe kushte më të mira kontraktuese.

⁷¹ Përderisa dy mësimdhënës goran të klasave 1-4 nuk lejoheshin të ktheheshin në shkollë, drejtori me sistem të Kosovës mori iniciativën për të nxjerrë ‘rregullat e shkollës’ dhe si reagim, të gjithë mësimdhënësit dhe nxënësit goran u tërhoqën nga shkolla më 17 mars. OSBE-ja ka kontaktuar të dy përfaqësuesit e komunës së Dragashit të cilët konsiderojnë ‘rregullat e shkollës’ si të pavlefshme (20 mars), dhe përfaqësuesi i Ministrisë së Arsimit të Serbisë në Kosovë i cili na sigurojë që fëmijët goran do të kthehen në shkollë menjëherë pas një vendimi të shkruar nga komuna për shfuqizimin e ‘rregullave të shkollës’ (23 mars). Komuna e ka përmbushur këtë kërkesë më 24 mars.

mbështetje në vlerat universale. Në Rahovec/Orahovac, një shkollë fillore shumetnike e themeluar në vitin 2001 në përpjekje për të ofruar nxënësit e komunitetit shqiptar, serb, rom, egjiptian, nuk është shfrytëzuar nga nxënësit serbë për shkak të mungesës së perceptuar të sigurisë dhe brengat e prindërve që arsimit Kosovar mund ta kufizojë mundësinë e vazhdimin të arsimimit jashtë Kosovës.

Arsimi fillor në Janjevë/Janjevo ilustron edhe më tej paradokset e bashkëjetesës. Shkolla i ka tre drejtorë dhe tre emra të ndryshëm. Drejtori i planprogramit në gjuhën serbe e quan atë ‘Vladimir Nazor’; drejtori kroat e quan atë ‘Janjevë’; komuna e Lipjanit/Lipljan dhe drejtori shqiptar e quajnë atë ‘Shtjefën Gjeqovi’. Drejtori kroat emërohet nga komuna por nxënësit e këtij komuniteti e ndjekin mësimin me planprogram në gjuhën serbe. Nxënësit shqiptarë, ashkali dhe turq mësojnë në gjuhën shqipe në katin e njëjtë; Nxënësit kroatë, boshnjakë dhe romë mësojnë në gjuhën serbe në katin tjetër.

Një shembull relativisht pozitiv vjen nga shkollat fillore të Mogila/Mogille dhe Binaç/Bincë (Viti/Vitina), ku disa klasë të sistemit arsimor të Kosovës dhe të atij në gjuhën serbe e ndajnë ndërtesën e shkollës gjatë ndërrimit të njëjtë. Në Poneš/Ponesh (Gjilan/Gnjilane) dhe në Jasenovik (Novobërdë/Novo Brdo), shkollat të cilat punojnë me dy sisteme të ndryshme ndajnë ndërtesën e njëjtë edhe pse në ndërrime të ndryshme. Organizimi i ndarjes së hapësirës e mundëson ose e pamundëson mundësinë e ndërveprimit ndërmjet nxënësve. Për shembull, në shkollën e Poneš/Poneshit ka pushim prej 45 minutave ndërmjet dy ndërrimeve dhe nxënësit e komuniteteve të ndryshme nuk takohen. Në Jasenovik pushimi prej 15 deri në 30 minuta ndërmjet ndërrimeve e mundëson njëllëj ndërveprimi ndërmjet nxënësve, sidomos gjatë verës kur ata merren me aktivitete sportive së bashku në oborrin e shkollës.

Paralelja e ndarë e shkollës fillore ‘Pandeli Sotiri’ në strehimoren e përkohshme në Plemetinë/Plemetina (Obiliq/Obilić), konsiderohet si shembull i arsimimit izolues dhe të cilësisë së dobët të cilin e vijojnë ekskluzivisht nxënësit romë dhe ashkali, dhe të cilët arsimohen nga mësimdhënësit jo të kualifikuar. Ndërtimi i një shkolle të re në fshatin e njëjtë do ta mundësojë integrimin e këtyre nxënësve me nxënësit shqiptarë në vitin e ardhshëm shkollor. Më 2008 dy klasë, të cilat më parë ishin të izoluar me 53 nxënës ashkali, egjiptianë dhe romë u integruan në mënyrë të suksesshme në shkollën fillore shumetnike “Selman Riza” Fushë Kosovë/Kosovo Polje.

Në disa raste, vetë fakti i ndarjes së shkollës ose klasës së njëjtë nuk do të thotë që është arritur integrimi. Në Ferizaj/Uroševac, të anketuarit ashkali kanë theksuar se, në disa raste gjatë dimrit, nxënësit e komunitetit të tyre po ulen në ulëset të cilat janë larg nga stufa dhe afër dritares. Jashtë shkollës, ata i ngacmojnë shpesh, ju drejtohen në mënyrë nënçmuese madje dhe rrihen nga nxënësit shqiptarë. Pas një varg rrahjesh të pohuara nga nxënësit shqiptarë,⁷² prindërit ashkali duket se po frikohen gjithnjë e më shumë që t’i dërgojnë fëmijët në shkollë.

⁷² Një varg i tërë i incidenteve të sulmit sipas pohimeve është bërë më 10 shkurt, 1 dhe 3 mars 2009.

4. PREZANTIMI I KOMUNITETEVE TË KOSOVËS NË TEKSTET SHKOLLORE

Në përputhje me Konventën Kornizë për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare të Këshillit të Evropës,⁷³ legjislacioni në fuqi mbi të drejtat e komuniteteve kërkon që planprogrami i Kosovës ta mbulojë historinë, kulturën dhe atributet e tjera të komuniteteve të cilat janë tradicionalisht të pranishme në Kosovë dhe ta nxisë frymën e respektit, të mirëkuptimit dhe të tolerancës në mesin e të gjithë atyre.⁷⁴ Aty po ashtu thuhet që organizatat përfaqësuese të komuniteteve duhet të konsultohen gjatë zhvillimit të planprogrameve të tilla. Në praktikë, në mjediset pas konfliktit, ekzistimi dhe praktika e dy sistemeve të ndara shkollore nuk është i favorshëm për krijimin e një sistemi të arsimit ndërkulturor ku ruhet identiteti i secilit grup, mësohet dhe pranohet identiteti i grupeve të tjera, dhe ku përkrahet mirëkuptimi, pranimi dhe toleranca reciproke. Përfaqësimet kontradiktore historike kanë tendencë që t'i japin prioritet ose komunitetit shqiptar ose atij serb. Ato nuk i marrin parasysh historitë specifike të komuniteteve të tjera ose e bëjnë këtë në mënyrë të pamjaftueshme. Mungesa e lëndëve të ashtuquajtura “nacionale” dhe të orëve të mësimi në gjuhën amtare për disa prej komuniteteve më të cenueshme (romë, ashkali, egjiptianë, goranë, kroatë, dhe malazezë) e pengon ruajtjen e duhur të identiteteve të tyre.

Ndarja dhe konflikti lidhur me kompetencat

Realiteti në Kosovë karakterizohet nga ndarja sociale, politike dhe administrative ndërmjet komunitetit shqiptar dhe atij serb të Kosovës. Ndarja dhe konflikti lidhur me kompetencat u bënë edhe më të shprehura pas 17 shkurtit 2008. Në fushën e arsimit, ekzistimi i dy sistemeve shkollore të ndara, të ndryshme dhe shpesh në konkurrencë me njëra tjetrën nuk është i përshtatshëm për mbështetje të “mirëkuptimit, tolerancës dhe miqësisë ndërmjet popujve, grupeve racore ose fetare” ose “kontribuimit në ruajtjen e paqes”, siç mbrohet në Deklaratën Universale për të Drejtat e Njeriut dhe Konventën Ndërkombëtare për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore.⁷⁵ Siç u shpjegua më lartë, nxënësit serbë i vijnë shkollat të cilat financohen dhe menaxhohen nga Ministria e Arsimit e Serbisë, ndërsa nxënësit shqiptarë i vijnë shkollat që mbahen financiarisht nga Ministria e Arsimit e Kosovës. Në përgjithësi, komunitetet më të vogla kanë prirje të gravitojnë drejt cilitdo planprogram varësisht, në radhë të parë, nga vendndodhja e tyre gjeografike dhe, në masë më të vogël, nga gjuha dhe/ose feja. Ata që jetojnë në enklavat serbe e zbatojnë planprogramin e Serbisë, ndërsa të tjerët normalisht e zbatojnë planprogramin e Kosovës.

Të dy sistemet arsimore në të vërtetë i kanë kontribuar thellimit të hendekut i cili i ndanë komunitetet në Kosovë. Është më se e qartë që edhe tekstet shkollore në gjuhën shqipe edhe ato në gjuhën serbe priren ta paraqesin një pikëpamje të shtrembëruar dhe të njëanshme të historisë. Ato nuk kufizohen vetëm në paraqitjen e historisë së

⁷³ Në nenin 6.1 të Konventës Kornizë për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare thuhet që autoritetet: “e inkurajojnë frymën e tolerancës dhe të dialogut ndërkulturor dhe marrin masa efektive për përkrahjen e respektimit dhe mirëkuptimit reciprok dhe të bashkëpunimit ndërmjet të gjithë personave të cilët jetojnë në territorin e tyre, pavarësisht nga identiteti etnik, kulturor, gjuhësor ose fetar të atyre personave, në veçanti në fushën e arsimit, të kulturës dhe të mediave.”

⁷⁴ Neni 8.12, 2008 Ligji për të drejtat e komuniteteve.

⁷⁵ Neni 26, Deklarata Universale për të Drejtat e Njeriut, 1948; Neni 13.1, Konventat Ndërkombëtare për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore; Komenti i përgjithshëm nr. 13: E drejta për t'u arsimuar, neni 13.4, Komiteti për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore, seanca njëzet e një (1999).

Kosovës, por prirën të shtyhen më shumë drejt paraqitjes së historisë së popullit shqiptar ose atij serb. Librat shkollorë të historisë në gjuhën shqipe përqendrohen në protagonistët e përkatësisë shqiptare, ndërsa thuhet që sllavët kanë ardhur në “tokat shqiptare” ku kanë luftuar, plaçkitur, shkatërruar dhe asimiluar fiset autoktone shqiptare (përveç në Kosovë dhe Shqipëri).⁷⁶ Tekstet shkollorë në gjuhën serbe janë po aq përjashtuese, duke e paraqitur Kosovën si “djep të popullit serb” dhe duke e nënvizuar që shqiptarët e Kosovës kanë ardhur nga Shqipëria.⁷⁷ Në të dy planprogramet, historitë e dy popujve paraqiten si një vazhdimësi afatgjate e shtypjes dhe luftës nacionale për t’u larguar nga Perandoria Osmane. Sipas versionit të historisë që mësohet në planprogramet e Kosovës, shtypja e popullit shqiptar dhe lufta e tyre kombëtare⁷⁸ nuk ka përfunduar me shpërbërjen e Perandorisë Osmane por ka vazhduar me përfshirjen e “detyruar” të Kosovës në Serbi.⁷⁹ Nxënësve serbë të klasës së tetë u mësohet se pjesa dërrmuese e shqiptarëve mbajnë bagëti dhe jetojnë në fshatra dhe që gjatë Luftës së II Botërore Kosova ishte pjesë e Shqipërisë së Madhe, gjatë së cilës kohë një numër i madh i serbëve të Kosovës ishin vrarë ose dëbuar në një përpjekje për ta pastruar Kosovën etnikisht.⁸⁰ Në përgjithësi, tekstet shkollorë të historisë në gjuhën serbe i shmangen historisë bashkëkohore të Ballkanit,⁸¹ ndërsa tekstet shkollorë në gjuhën shqipe nuk e bëjnë këtë.⁸² Fëmijët shqiptarë të shkollës fillore, për shembull, mësojnë për masakrimet e shqiptarëve të Kosovës të kryera nga ushtria dhe policia serbe më 1998-1999.⁸³ Vetëm komandantit të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës Adem Jasharit i janë kushtuar dy faqe.

⁷⁶ Fehmi Rexhepi & Frasher Demaj, 2006, Historia 6, Libri Shkollor Prishtina, p. 113-4.

⁷⁷ Suzana Rajić, Kosta Nikolić & Nebojša Jovanović, 2005, Historia 8: për klasën e 8 të shkollës fillore, botuar nga “Kultura” Bački Petrovac, p. 27 & 134-5.

⁷⁸ “Liritë dhe të drejtat politike të premtuara nga Turqit e rinj nuk ishin jetëgjatë. Pasi që vendosën autoritetin e tyre, ata filluan me veprime kundër lëvizjes kombëtare shqiptare. Turqit e rinj filluan të krijojnë vështirësi shkollave shqipe dhe klubeve kulturore, dhe filluan të arrestojnë patriotët shqiptarë etj. Këto veprime si dhe taksat dhe shërbimi ushtarak nxitën zemërimin e popullatës shqiptare kundër regjimit të Turqve të rinj ... Në fshehtësi, komitetit shqiptar filloi përpjekjet për organizimin e trazirave të armatosura kundër Otomanëve. Në fillim të prillit 1910 trazirat shpërthyen në regjionin e Prishtinës. Ato u përhapën shpejt në vende tjera nëpër gjithë provincën e Kosovës dhe Dibrës”. Fehmi Rexhepi dhe Frasher Demaj 2005, Historia 8 shkolla e mesme e ulet, Shtepia Botuese “Libri Shkollor” Prishtinë, faqe 105. Shih gjithashtu faqet : 68, 78 & 104-111.

⁷⁹ Më vonë më 1918 e përfshirë në Mbretërinë e serbëve, kroatëve dhe sllovenëve, si pjesë e Serbisë.

⁸⁰ Suzana Rajić, Kosta Nikolić & Nebojša Jovanović, 2005, Historia 8: Për klasën e 8 të shkollës fillore, botues “Kultura” Bački Petrovac, f. 27 & 134-5.

⁸¹ Në një ekzemplar të librave të historisë të klasës së pestë dhe të tetë, për shembull, nuk përmendet konflikti 1998-1999 në Kosovë. Epoka e Miloseviçit përshkruhet në vija të përgjithshme si periudhë gjatë së cilës janë përkeqësuar marrëdhëniet me republikat e tjera të ish-Jugosllavisë.

⁸² Sipas librave të historisë në gjuhën shqipe për klasën 6 deri në 9.

⁸³ “Në këto kushte okupatorët Serb iniciuan makinerinë propaganduese ushtarake dhe politike kundër UÇK-së (Ushtria Çlirimtare e Kosovës) por edhe kundër popullatës civile, si rezultat i së cilës ishin skenat e pabesueshme të barbarizmit, vrasjeve dhe masakrave të njerëzve të pafajshëm (fëmijëve, grave dhe pleqve), dhe duke djegur shtëpi dhe duke burgosur numër të madhe e të rinjve, etj. Masakrat më të mëdha u realizuan gjatë shkurtit 1998 posaçërisht në regjionin e Drenicës. Masakra të ngjashme mbi popullatën civile shqiptare u bënë gjat tërë viti 1998 në të gjithë Kosovën.” Burim: Fehmi Rexhepi, 2006, Historia 9, Libri Shkollor, Prishtinë, f. 168. Rajoni i Drenicë/Drenica përfshin komunat Skenderaj/Srbica, Glogoc/Glogovac dhe Malishevë/Mališevo, si dhe pjesën jug-lindore të regjionit të Mitrovicës/Mitrovica . Në versionin në gjuhën boshnjake të “Njeriu dhe natyra”, thuhet: “Pushtetit serb, përkundër shumë përpjekjeve nuk ka arritur ta ndryshojë strukturën etnike të banorëve në vendin tim. Marrëzja e këtyre barbarëve e arriti kulmin ndërmjet 24 marsit dhe 12 qershorit. Burim: ” Rasim Bejtullahu, Muhamet Bicaj, Ragip Rrustemi, “Njeriu dhe natyra”, klasa e tretë e shkollës fillore, Libri Shkollor, Prishtinë 2007, f. 67.

Shkollat që punojnë me planprograme të Serbisë

Planprogrami i Serbisë për arsimin fillor (klasat 1-4) i përfshinë 20 orë mësimore në javë, 9 prej të cilave i kushtohen mësimi të gjuhës serbe, letërsisë, artit, muzikës dhe fesë. Mësimi i historisë fillon në klasën e pestë. Në klasat 5-8 numri i orëve mësimore shtohet prej 27 në 30 dhe përafërsisht një e treta e orëve mësimore (ose 10 orë) vazhdojnë t'ju kushtohen lëndëve kombëtare. Ky planprogram zbatohet në tërë Serbinë, duke mos ju referuar në mënyrë të posaçme serbëve të Kosovës. Tekstet shkollore nuk e paraqesin historinë e Kosovës, por atë të popullit serb në përgjithësi, dhe nuk merren me historinë bashkëkohore (periudhën prej 1998 deri tani) ose e mbulojnë atë vetëm përmes prezantimit të përgjithshëm të fakteve dhe të datave pa i analizuar ato. Nxënësit serbë të Kosovës mësojnë kryesisht për shqiptarët dhe historinë e tyre prej Luftës së II-të Botërore e më tej. Sa i përket gjeografisë, fëmijët mësohen që Kosova është krahina jugore e Serbisë ku jetojnë pjesa më e madhe e pakicës shqiptare.⁸⁴

Të anketuarit kanë mendime të ndryshme lidhur me përmbajtjen aktuale të teksteve shkollore në gjuhën serbe dhe mënyrën si i paraqesin ato komunitetet e tjera. Këto mendime ndryshojnë prej teksteve shkollore që ofrojnë informata gjithëpërfshirëse lidhur me etnitë të cilat tradicionalisht jetojnë në Kosovë,⁸⁵ deri te librat e gjeografisë dhe të historisë të cilat i përmendin të gjitha komunitetet që tradicionalisht kanë qenë të pranishme në Serbi, përfshirë Kosovën,⁸⁶ dhe të dhënat për kombet dhe kombësitë të cilat janë përfshirë në disa mësimore për komunitetet (boshnjakët, kroatët dhe shqiptarët), duke e përmendur komunitetin turk në mënyrë të kufizuar.⁸⁷

Në disa raste janë plotësuar nevojat gjuhësore të komuniteteve të tjera, si në shkollën e Janjevë/Janjevo (Lipjan/Lipljan), ku nxënësit kroatë, boshnjakë dhe romë mund të mësojnë në gjuhën e tyre tri orë në javë. Nga viti 2003, në një shkollë në Mitrovica/Mitrovicë veriore dhe në disa shkolla fillore në Gjilan/Gnjilane, Kamenicë/Kamenica and Ugljare/Ugljar (Fushë Kosovë/Kosovo Polje), nxënësvë romë ju ofrohen dy orë të gramatikës në javë. Polemika lidhur me shprehjen e gjuhës rome në alfabetin cirilik apo latin është zgjidhur në favor të librave në alfabetin latin.

⁸⁴ Konsultimi i teksteve shkollore dhe diskutimet me nxënësit serbë në Štrpce/Shtërpçë, Viti/Vitina, Gjilan/Gnjilane, Novobërdë/Novo Brdo, dhe Kamenicë/Kamenica. Shih gjithashtu Rada Sitarica dhe Milutin Tadić, 2008, Gjeografia për klasën e gjashtë të shkollës fillore, Instituti i librit shkollor, Beograd, f. 90-91 ku të dhënat statistikore të vitit 2002 për Serbinë gjithashtu përfshijnë Kosovën dhe Metohinë: “numri i popullatës: 9,396,000 (sipas vlerësimit për vitin 2001 numri i banorëve për Kosovë dhe Metohi është 1,900,000)” dhe aty ku paraqiten hartat e Serbisë, në faqet 90 dhe 91, këto përfshijnë edhe Kosovën. Rada Sitarica dhe Milutin Tadić, 2008, Fletore pune e gjeografisë për klasën e gjashtë të shkollës fillore, Instituti i librit shkollor, Beograd, f. 66 (aty ku është shpjegohet territori i Serbisë thuhet se ai është i përbërë nga Serbia qendrore, Vojvodina, dhe Kosova dhe Metohia) dhe f. 63 (në hartën e Serbisë aty ku paraqiten anët e botës, Kosova në cepin më jugor të saj paraqitet si kufiri me jugor i Serbisë).

⁸⁵ Sipas mësimdhënësve në Gorazdevac/Gorazhdec, Sigë/Siga, Brestovik/Brestovikë (Pejë/Peć), dhe Osojane/Osojan (Istog/Istok), historia e serbëve dhe e shtetit serb mësohet në arsimin fillor dhe atë të mesëm; tekstet e historisë ofrojnë informata gjithëpërfshirëse lidhur me etnitë që tradicionalisht jetojnë në Kosovë; dhe historia e komunitetit shqiptar mbulohet nga vendosja e fiseve ilire, nëpër pushtimin osman, konvertimin në fenë islame, luftërat e Ballkanit, Lidhjen e parë dhe të dytë të Prizrenit, luftërat botërore, dhe ngjarjet e të tetëdhjetave dhe të nëntëdhjetave. Komuniteti rom dhe ai boshnjak në Kosovë po ashtu përfshihen në mësimet që kanë të bëjnë me historinë e rajonit..

⁸⁶ Drejtorët e shkollave dhe mësimdhënësit në Rahovec/Orahovac and Velika Hoča/Hoçë e Madhe.

⁸⁷ Të anketuarit në Prishtinë theksojnë që në planprogramin e Serbisë paraqiten të dhëna për kombet dhe kombësitë, përfshirë boshnjakët, kroatët dhe shqiptarët, duke u përqendruar në ish-Jugosllavi ose në kontekstin e Ballkanit. Komuniteti turk përmendet vetëm në lidhje me Perandorinë Osmane.

Megjithatë, edhe pse masat *ad hoc* ua mundësojnë fëmijëve të mësojnë në gjuhën amtare, nuk ka ndonjë masë për përkrahjen dhe mësimin e kulturës, të historisë dhe fesë së tyre.

Në Dragash/Dragaš, drejtorët e shkollave ku nxënësit goranë e vijojnë mësimin fillor dhe të mesëm në gjuhën serbe e kanë vërtetuar që, ashtu si lejohet me legjislacionin e Serbisë për arsimin, mësimdhënësit e ndryshojnë planprogramin deri në 30 për qind në mënyrë që ta përfshijnë historinë, kulturën dhe atributet e tjera specifike të komuniteteve vendore. Prandaj, prindërit dhe nxënësit mendojnë që komuniteti i tyre është i përfaqësuar mjaftueshëm në tekstet shkollore dhe në procesin mësimor. Megjithatë, në materialin mësimor komuniteti goran përmendet pak. Nxënësit boshnjakë të cilët e zbatojnë planprogramin e Serbisë në Mitrovica/Mitrovicë veriore dhe në Leposavić/Leposaviq besojnë që historia dhe kultura e komunitetit të tyre nuk pranohet si duhet, pasi që ata e mësojnë historinë dhe kulturën e Serbisë, duke ofruar pak ndryshime, plotësime apo lëndë plotësuese për identitetin e boshnjakëve.⁸⁸

Shkollat të cilat punojnë me planprogram të Kosovës

Në planprogramin e Kosovës, gjatë arsimit fillor (klasat 1-5) lëndët kombëtare për gjuhën amtare, artin, muzikën dhe historinë e mbulojnë prej një të tretës deri në gjysmë (9-11 orë) të normës së përgjithshme të orëve (20 deri në 25 orë). Të mësuarit e historisë fillon në klasën e pestë. Lëndët kombëtare paraqesin pak më pak se një të tretën e programit mësimor në arsimin e mesëm të ulët (klasat 6-9).

Në komunat veriore të Leposavić/Leposaviq, Zvečan/Zveçan and Zubin Potok, komuniteti i izoluar shqiptar ndjekë mësimin fillor në gjuhën amtare sipas planprogramit të Kosovës, përfshirë lëndët “nacionale” specifike për bashkësinë. Arsimi i mesëm dhe i lartë në gjuhën amtare ofrohet vetëm në jug të lumit Ibër/Ibar. Nuk ka ndonjë nismë për vënien e kontakteve me nxënësit serbë ose për përkrahjen e të mësuarit për këtë komunitet apo gjuhën e tij.

Nxënësit turq ndjekin mësimin ose në gjuhën turke⁸⁹ ose shqipe⁹⁰. Planprogrami në gjuhën turke i përfshinë lëndët “nacionale” specifike për bashkësinë, programi mësimor i të cilave është hartuar nga ekspertët turq. Njëzet deri në 30 për qind të librave të historisë e mbulojnë historinë e komunitetit turk si edhe të Turqisë dhe ndikimin e saj në Ballkan. Përderisa tekstet shkollore të bazuara në planprogramin mësimor për arsimin fillor janë në përgjithësi të disponueshme, ato të cilat shfrytëzohen në arsimin e mesëm importohen nga Turqia dhe nuk e përmendin Kosovën dhe komunitetin turk në Kosovë. Të anketuarit në Prishtinë dhe në Mitrovicë nuk janë të kënaqur me përfaqësimin e pamjaftueshëm të komunitetit të tyre në planprogramin e Kosovës dhe janë të brengosur për paraqitjen e turqve në librat e historisë si pushtues. Pas një ankese të komunitetit turk dhe rekomandimeve të Zyrës ndërlidhëse të Republikës së Turqisë në Kosovë, më 2007 Ministria e arsimit ka bërë ndryshime në planprogram dhe në tekste shkollore, duke e bërë të mundur një

⁸⁸ Komuniteti i boshnjakëve është i brengosur për ruajtjen e identitetit të tyre kulturor dhe fetar në planprogramin e Serbisë dhe i kritikon mësimdhënësit dhe drejtorët e shkollave që janë të pandjeshëm për veçantitë e identitetit të tyre. Për shembull, lënda ‘Studime fetare’ e futur rishtazi në shkolla ka shkaktuar shqetësim të posaçëm kur drejtori në Mitrovicë/Mitrovica veriore në fillim ka insistuar që nxënësi boshnjakë dhe serbë t’i vijojnë orët e njëjta të mësimit lidhur me këtë lëndë.

⁸⁹ Prizren, Mamuşa/Mamushë/Mamuşa, Gjilan/Gnjilane, and Prishtinë/Priştina.

⁹⁰ Mitrovicë/Mitrovica, Vushtrri/Vučitrn, Janjevo/Janjevë (Lipjan/Lipljan).

përfaqësim më objektiv kulturor dhe historik të këtij komuniteti. Ndonëse në Mitrovicë/Mitrovica dhe Vushtrri/Vučitrn komuniteti turk nuk ka kërkuar të ndjekë mësimin në gjuhën amtare dhe të ketë lëndë kombëtare,⁹¹ përfaqësuesi turk në Janjevë/Janjevo (Lipjan/Lipljan) e ka bërë këtë rishtazi.

Të anketuarit boshnjakë në Prishtinë/Priština nuk janë të kënaqur me përfaqësimin e pamjaftueshëm të komunitetit të tyre në planprogramin e Kosovës. Paraqitja negative e komunitetit serb, sidomos në lidhje me konfliktin e fundit, është i dukshëm në disa libra të cilat i shfrytëzojnë nxënësit boshnjakë.⁹² Këta nxënës vazhdimisht e konfirmojnë që ata mësojnë mjaftueshëm për gjuhën dhe letërsinë boshnjake, por që kanë nevojë të mësojnë më shumë për historinë e boshnjakëve të Kosovës. Mësimdhënësit në gjuhën boshnjake kanë nevojë për mbështetje të mëtijshme lidhur me tekstet shkollore dhe me organizimin e aktiviteteve arsimore dhe kulturore që do ta rrisnin motivimin e nxënësve dhe do t'i ndihmonin ata ta tejçonin dhe ruanin identitetin e komunitetit të tyre.

Gjuha rome dhe historia dhe kultura e romëve, ashkalive dhe egjiptianëve nuk janë përfshirë në planprogramin e Kosovës. Prindërit romë në Klinë/Klina janë të shqetësuar që fëmijët e tyre nuk mund të flasin ose të mësojnë në gjuhën e tyre përveç në jetën private, dhe që ata rrezikojnë ta humbin trashëgiminë e tyre historike dhe kulturore. Të anketuarit romë, ashkali dhe egjiptianë të cilët e ndjekin sistemin arsimor ose të Serbisë ose të Kosovës kërkojnë që këto planprograme të ndryshohen në mënyrë që t'i përfshijnë informatat ose lëndët lidhur me kulturën, historinë, dhe identitetin.⁹³ Të anketuarit ashkali po ashtu theksojnë që planprogrami i Kosovës nuk ua mundëson fëmijëve të mësojnë për identitetet e komuniteteve joshumicë.⁹⁴ Të anketuarit romë dhe egjiptianë janë kundër librave të Kosovës të cilat i paraqesin ata në mënyrë të thjeshtëzuar duke pohuar që origjina e tyre është në Indi dhe Egjipt.

Derisa në Prizren dhe Ferizaj/Uroševac, komuniteti rom ka marrë iniciativa të ndryshme me qëllim të ndërtimit të moduleve arsimore mbi kulturën, historinë dhe traditën e tyre,⁹⁵ komunitetet egjiptiane dhe ashkali në Pejë/Peć dhe në Mitrovicë/Mitrovica ndajnë traditat gjuhësore dhe fetare të komunitetit shqiptar, si dhe nxjerrin prioritetin e integritetit arsimor mbi futjen e lëndëve arsimore të veçanta për komunitetin. Komuniteti rom, ashkali e egjiptian në rajonin e Prizrenit ka shprehur pritje të larta në lidhje me zbatimin e Strategjisë së Qeverisë për Integritetin e Romëve, Ashkalive dhe Egjiptianëve në Kosovë, e cila parashikon ndërtimin e “moduleve bazë mbi traditën, kulturën dhe historinë e komunitetit rom, ashkali dhe

⁹¹ Vetë-kërkimi i identitetit duket të jetë i varur nga konteksti. Pjesëtarët e komunitetit deklarohen turq kur kjo ju konvenon dhe herëve të tjera integrohen në komunitetin shqiptar, ashtu siç duket që ka ndodhur në sistemin arsimor.

⁹² Shih shënimin në fund të faqes nr. 79. Burimi: Rasim Bejtullahu, Muhamet Bicaçaj, Ragip Rustemi, “Njeriu dhe natyra”, klasa e tretë e shkollës fillore, Libri Shkollor, Prishtinë/Priština 2007, f. 67.

⁹³ Të anketuarit romë, ashkali dhe egjiptianë në Obiliq/Obilić, Hallaq i Vogël/Mali Alaš (Lipjan/Lipljan), Klinë/Klina and Shtime/Štimlje.

⁹⁴ Të anketuarit në Fushë Kosovë/Kosovo Polje dhe Podujevë/Podujevo.

⁹⁵ Me kërkesë të komuniteteve në Gjiilan/Gnjilane, Prizren and Gračanica/Graçanicë, një shkrimtar nga Prizreni ka themeluar një komision për të punuar në planprogramin për komunitetin rom më 2002. Komisioni kurrë nuk ka propozuar rekomandime e ndryshime në planprogramet. Më 2003 dhe 2006, komuniteti rom në Ferizaj dhe Prizren gjithashtu ka kërkuar lëndë shtesë në gjuhën rome dhe ka propozuar një planprogram për një lëndë mbi gjuhën, kulturën dhe historinë rome.

egjiptianë në planprogramet e përgjithshme në gjuhë tjera të mësimdhënies.”⁹⁶ Më 2009, një projekt i Ministrisë së Arsimit synon të trajtojë këtë mungesë për komunitetin rom, duke hartuar një lëndë mësimore në gjuhën rome.⁹⁷ Projekti përfshin pjesëmarrjen e përfaqësuesve të komunitetit rom, por financimi i tij, periudha e shkurtër e parashikuar për hartimin e saj, mungesa e planeve të qarta afatgjate institucionale në lidhje me trajnimin e një numri të mjaftueshëm të mësimdhënësve të gjuhës rome, si dhe mungesa e një vlerësimi adekuat të kërkesës së mundshme dhe shpenzimeve financiare për botimin e librave, janë fakte që kërkojnë që projekti të zhvillohet më tutje për të arritur ndikimin e qëndrueshëm.⁹⁸

5. MËSIMI I GJUHËS ZYRTARE NGA STUDENTËT JOSHUMICË

Sipas legjislacionit në fuqi në Kosovë, shkollat fillore dhe të mesme, apo paralelet në të cilat gjuha e mësimdhënies nuk është gjuhë zyrtare, nxënësit janë të obliguar të studiojnë në një gjuhë zyrtare të zgjedhur nga ata.⁹⁹ Megjithatë, planprogrami kosovar në gjuhët boshnjake dhe turke nuk parashikon një lëndë të gjuhës së dytë zyrtare zgjedhore si lëndë obligative, por më shumë si një prej lëndëve shtesë të cilat mund të zgjidhen nga prindërit dhe nxënësit. Prindërit boshnjakë dhe turq në Kosovë vazhdimisht shfrytëzojnë këtë mundësi, dhe kërkojnë që fëmijët e tyre të ndjekin dy orë shtesë në javë në gjuhën shqipe.¹⁰⁰ Derisa prindërit në teori e kanë këtë mundësi, ata nuk mund të zgjedhin gjuhën serbe, pasi nuk ka lëndë të tillë e as planprogram për arsimin në gjuhën serbe.

Arsimi i pamjaftueshëm dhe joadekuat në gjuhën shqipe rezulton në mësimin e dobët të kësaj gjuhe, e edhe mundësi më të pakta për integrim arsimor e punësim, duke vënë kështu në vështirësi studentët që nuk e kanë gjuhën shqipe gjuhë amtare. Siç është theksuar nga studentët boshnjakë dhe turq në Prizren, derisa Ministria e Arsimit ka hartuar një planprogram për gjuhën e dytë zgjedhore në shqip, librat shkollorë nuk janë botuar dhe nuk janë në dispozicion. Në vend të kësaj, mësimdhënësit dhe nxënësit marrin libra shkollorë për nxënës me gjuhë amtare shqipe, të cilët janë tejet të ndërlikuar dhe nuk përdoren në praktikë. Në shkollën fillore të Dobrushës/Dobruša (Istog/Istok), situata është edhe më e keqe, duke marrë parasysh që nuk ka asnjë libër të shqipes për nxënësit boshnjakë, për asnjë klasë. Sipas nxënësve dhe prindërve boshnjakë në rajonin e Pejës/Peć, orët e gjuhës shqipe kanë cilësi të mirë, por janë të pamjaftueshme në numër dhe s’janë të shpeshta për të mundësuar njohje të mirë të gjuhës. Nxënësit boshnjakë të shkollave të mesme që nuk janë të aftë në gjuhën shqipe nuk mund të përfitojnë mundësitë e praktikës që ofrohen për shqiptarët në firmat private të rajonit. Pas arsimimit të tyre, do të kenë vështirësi të punojnë në ndërmarrjet shqipfolëse, përkundër aftësisë dhe ekspertizës së tyre.

⁹⁶ Strategjia për integrimin e komuniteteve rome, ashkali dhe egjiptiane egjiptiane në Kosovë, 2008, p. 24.

⁹⁷ Projekti i Ministrisë së Arsimit për “Planprogramin në gjuhën rome, si gjuhë amtare për romë, egjiptian dhe ashkali”, prill 2008.

⁹⁸ Më 2004, një studim fizibiliteti i mbështetur nga OSBE-ja dhe Ministria e Arsimit rekomandoi që hartimi i planprogramit të gjuhës rome të përfshijë ekspertizën e jashtme (nga vendet ku janë hartuar planprograme të ngjashme), të ligjërohet nga mësimdhënësit e komunitetit rom, si dhe ofrohet aftësim i kualifikuar jetëgjatë për mësimdhënësit e gjuhës rome.

⁹⁹ Neni 21.1, Ligji mbi përdorimin e gjuhëve; neni 8.10, Ligji i 2008-ës mbi të Drejtat e Komuniteteve; Ministria e Arsimit, Udhëzimi Administrativ Nr. 10/2007 mbi Mësimin në gjuhën zgjedhore zyrtare.

¹⁰⁰ Siç konfirmohet në regjionet e Prizrenit, Pejës/Peć, Gjilanit/Gnjilane dhe Prishtinës/Priština.

Mjedisi social dhe mundësitë e socializimit të ofruara me kontakte me moshatarët e bashkësisë shqiptare në Kosovë kanë rol kryesor në mësimin e suksesshëm të gjuhës shqipe. Për shembull, në Pejë/Peć, fëmijët boshnjakë që nuk vijnë nga fshatrat e përziera ku gjuha shqipe është dominuese, kanë më shumë vështirësi dhe më pak mundësi të mësojnë këtë gjuhë. Mësimdhënësit propozojnë kurse verore të gjuhës shqipe për të ndihmuar në tejkalimin e mungesave. Orët shtesë në gjuhën shqipe brenda orëve të rregullta të mësimin do të ishin ngarkesë e tepërt për këta nxënës. Megjithatë, nuk do të ishte mbingarkesë nëse orët zgjedhore në gjuhën zyrtare do të ishin lëndë obligative mësimore. Studentët turq në Gjilan/Gnjilane mësojnë shqipen nga mësimdhënësit që e kanë gjuhë amtare. Në fund të shkollimit të mesëm, ata integrohen mirë në shoqërinë shqiptare të Kosovës, si dhe kanë njohuri të mira të gjuhës shqipe. Megjithatë, rezultati duket të jetë i lidhur me faktorët e shoqërimit (si afërsia fizike me moshatarë shqiptarë dhe marrëdhëniet me ta, në sfera private e publike), e jo aq shumë si tregues i një cilësie të mirë të arsimit formal në gjuhën shqipe. Dy orë të gjuhës shqipe në javë do të ishin të pamjaftueshme pa pasur mundësi përcjellëse të mësimin social.

Gjatë moshës së shkollës fillore, njohuria e dobët e gjuhëve të njëri-tjetrit seriozisht kufizon ndërveprimin mes fëmijëve turq dhe shqiptarë në Kosovë. Nxënësit turq nuk flasin shqipe të rrjedhshme, si dhe e kanë të vështirë të hyjnë në aktivitete të përditshme me fëmijët shqiptarë. Situata përmirësohet paksa në shkollimin e mesëm, ku njohuria më e mirë e gjuhës shqipe ndihmon marrëdhëniet dhe shoqërimin edhe jashtë lokaleve shkollore. Gjatë kësaj faze, studentët turq kanë aktivitete të përbashkëta (sportive e tjera) me moshatarët shqiptarë më shpesh se studentet. Kjo gjë vendos një dallim të dukshëm të njohurive gjuhësore që fitohen nga djemtë dhe vajzat turke, duke i lënë vajzat më të ekspozuara ndaj rrezikut të përjashtimit.

Të dy planprogramet, ai i Serbisë dhe ai i Kosovës, në mënyrë të barabartë dështojnë në ofrimin e mundësive për mësimin e gjuhës tjetër zyrtare. Në këtë kuptim, gjeneratat e ardhshme të dy komuniteteve më të mëdha nuk do të jenë në gjendje të komunikojnë me njëri-tjetrin (përveç në gjuhë të huaj). Në të ardhmen, shërbimi civil i Kosovës ka mundësi të përbëhet nga nëpunës që nuk janë në gjendje t'i flasin të dy gjuhët zyrtare. Kështu, zbatimi i Ligjit mbi Përdorimin e Gjuhëve dhe përdorimi i barabartë i gjuhëve zyrtare është në rrezik. I vetmi përjashtim në këtë vazhdimësi negative vërehet në Dragash/Dragaš, ku nxënësit goranë me planprograme të Serbisë mësojnë dy orë fakultative të gjuhës shqipe në javë, në klasat 3-8.

6. PËRFUNDIME DHE REKOMANDIME

Siç ka konkluduar Seminari i Montrealit për Arsimin Ndërkulturor dhe Shumëkulturor: “Arsimi shumëkulturor përfshin politikat dhe praktikën arsimore që plotësojnë nevojat e veçanta arsimore të grupeve shoqërore, që ju përkasin traditave të ndryshme kulturore, ndërsa arsimi ndërkulturor përfshin politikat dhe praktikën arsimore përmes së cilave pjesëtarët e kulturave të ndryshme, qofshin ata në pozitën e shumicës apo pakicës, mësojnë të ndërveprojnë me njëri tjetrin në mënyrë konstruktive. Arsimi ndërkulturor ka për synim nxjerrjen në pah ruajtjen e identitetit të secilit grup, që shoqërohet me pranimin e larmisë dhe tolerancës. Në këtë kuptim, arsimi ndërkulturor kërkon që si pakica ashtu edhe shumica të mësojnë për njëri

tjetrin, për karakteristikat e veçanta kulturore, historinë e tyre përkatëse dhe për vlerën e tolerancës dhe të pluralizmit”.¹⁰¹ Deri në një masë, planprogramet e veçanta në Kosovë plotësojnë nevojat arsimore brendakulturore të komuniteteve të veçanta, por nuk përmbajnë promovimin e respektit të ndërsjellë, mirëkuptimit dhe tolerancës. Praktikrat e sistemeve të ndara arsimore paraqesin nevojën për iniciativë në promovimin e integritit brenda larmisë dhe arsimit ndërkulturor.

Përveç procesit aktual të reformës së planprogrameve, proceset përcjellëse të drejtësisë kalimtare, dialogut ndëretnik dhe kërkimit të së vërtetës, do t'i ndihmonin bashkësive në Kosovë të ndërtojnë një qëndrim me mirëkuptim të dyanshëm dhe të pajtuar mbi të kaluarën e afërt. Një histori më e balancuar, e larmishme dhe e pajtueshme është thelbësore, e tillë që do të përfaqëonte e jo të ndante bashkësitë. Deri atëherë, idealisht do “të duhej” të kishte moratorium mbi mësimdhënien e historisë moderne. Nëse jo, paragjykimet dhe urrejtja etnike vetëm sa do të përforconte ndarjet e ngulitura dhe ankesat historike, të cilat mund të nxisin konflikte të mëtutjeshme. E kaluara zakonisht nuk kuptohet si punë e përfunduar, por më shumë si një justifikim i ngulitur thellë për veprimet e djeshme – e ka mundësi të madhe edhe për të nesërmet. Ashtu si janë gjërat sot, gjenerata e re e rinisë kosovare nga bashkësi të ndryshme do ta ketë të vështirë të komunikojë, përmes një gjuhë të kuptueshme mes vete, një historie të përbashkët e të pandarë, apo një kulture.

Në kontekstin e resurseve të kufizuara dhe përkundër përparimit të arritur, brenda sistemeve arsimore të Kosovës, nxënësit që i përkasin komuniteteve të vogla vazhdojnë të kenë më pak mundësi për ruajtjen, zhvillimin dhe nxitjen e njohurisë së kulturës dhe identitetit të tyre. Në këtë kuptim, nuk ofrohen lëndët e gjuhës, historisë, artit dhe muzikës së romëve, egjiptianëve, ashkalive, goranëve, kroatëve dhe malazezëve të Kosovës. Nuk ka libra shkollorë turqisht e boshnjakisht të bazuar në planprogramet për shkollim të mesëm, derisa fondet e ndara për botimin e tyre janë të pamjaftueshme.

Në anën tjetër, ndarja mes nxënësve të dy sistemeve arsimore, mundësia joadekuate për integrim, e në disa raste edhe ngacmimi i studentëve të bashkësive joshumicë vazhdojnë të mbeten çështje shqetësuese. Derisa nuk ka planprogram të Kosovës në gjuhën serbe, nxënësit dhe mësimdhënësit të sistemeve të ndara shkollore nuk kanë kontakte, ndërsa arsimit dygjuhësh që mundëson mësimin e të dyja gjuhëve zyrtare nuk ofrohet. Në planprogramin e Kosovës, nxënësit që mësojnë në gjuhë jozyrtare kanë mundësi të ndjekin orë të gjuhës shqipe, por jo të asaj serbe. Për më tepër, arsimit i pamjaftueshëm dhe i papërshtatshëm në gjuhën shqipe për studentë joshqiptarë rezultojnë në nxënie të dobët të kësaj gjuhe, e kështu edhe mundësi më të pakta për integrim punësimi dhe edukimi.

Për këto arsye, OSBE-ja rekomandon që sistemet arsimore në Kosovë:

- Të caktojnë prioritetet për zhvillimin pjesëmarrës të planprogrameve dhe lëndëve “nacionale” specifike për bashkësinë, për gjuhën, historinë, artin dhe muzikën e komuniteteve më të cënueshme.

¹⁰¹ Seminari i Montrealit për Arsimin Ndërkulturor dhe Shumëkulturor, 31 mars 2000, paragrafi 6, E/CN.4/Sub.2/AC.5/2000/WP.4, Komisioni për të drejta të njeriut e Kombeve të Bashkuara, Nën-komisioni mbi promovimin dhe mbrojtjen e drejtave të njeriut, Grupi punues për minoritetet, Seanca e gjashtë.

- Të zgjerojnë më tutje studimet e larta në gjuhët jozyrtare për të rritur numrin e mësimitdhënësve të kualifikuar dhe të nxisin arsimin dhe aftësimin profesional për këta mësimitdhënës.
- Të sigurojnë subvencionimin e plotë të botimit dhe shpërndarjes së librave shkollorë në boshnjakisht dhe turqisht për arsimin fillor dhe të mesëm, të përmirësojnë i cilësinë e librave të lëndëve nacionale dhe të sigurojnë përkthimin profesional të librave të lëndëve të përgjithshme.
- Të fusin lëndën e arsimit ndërkulturor dhe mbi komunitetet e të drejtat e tyre të përgjithshme si çështje ndërprogramore,¹⁰² për të promovuar arsimin ndërkulturor.
- Të promovojnë në mënyrë të vazhdueshme mundësitë e mësimit social, të ndërveprimit dhe të kontakteve në mes të nxënësve dhe të mësimitdhënësve të të gjitha komuniteteve e sistemeve arsimore.
- Të parandalojnë dhe trajtojnë, sidomos në nivelin shkollor, aktet e diskriminimit, të armiqësisë apo të dhunës ndaj të cilëve nxënësit kanë qenë apo mund të jenë të nënshtruar, si rezultat i identitetit të tyre etnik, kulturor, fetar apo gjuhësor.
- Të ofrojnë, në baza vullnetare, orë shtesë në gjuhën e dytë zyrtare në të dy planprogramet.
- Të ofrojnë, në pajtim me Rekomandimet e Hagës në lidhje me të Drejtat Arsimore të Pakicave Kombëtare¹⁰³ ku gjuha amtare është tjetër nga gjuha/gjuhët zyrtare si dhe në përputhje me dëshirat e prindërve dhe të nxënësve:
 - *arsim parashkollor dhe kopshte* në gjuhën amtare të fëmijës;
 - *shkolla fillore* në gjuhën amtare, me shtimin e një lënde në gjuhën(t) zyrtare që ligjërohet në baza të rregullta, si dhe futjen, deri kah fundi i kësaj periudhe, i disa lëndëve praktike të ligjëruara përmes mediumit të gjuhës zyrtare;
 - *një pjesë të konsiderueshme të planprogramit të shkollës së mesme* në gjuhën amtare duke siguruar që gjuhët zyrtare ligjërohen rregullisht, si dhe që numri i lëndëve të ligjëruara në gjuhët zyrtare të rritet gradualisht.

¹⁰² Korniza e planprogramit kosovar të vitit 2001 parashikon lëndët në vijim si lëndë ndër-programore: aftësitë jetësore dhe personale; qytetërimi demokratik dhe të drejtat njerëzore; ndërmarrësia; mjedisi; teknologjia e informimit dhe komunikimit; si dhe mediat.

¹⁰³ Rekomandimet e lëshuara nën ombrellën e Komisarit të Lartë të OSBE-së për Pakicat Kombëtare, Hagë, tetor 1996, paragrafët 11-13.

7. SHTOJCA 1. Të anketuarit nga OSBE-ja, të ndarë sipas bashkësisë, gjinisë dhe kategorisë (janar-shkurt 2009)

Bashkësia	Të anketuarit në kategori	Nxënësit fillorë	Nxënësit e mesëm	Prindërit	Mësuesit e fillores	Mësuesit e të mesmes	Drejtorët e fillores	Drejtorët e të mesmes	DKA	Total	%
	Gjinia										
Shqiptarët në veri	<i>Femër</i>	0	0	2	6	1	1	0	3	13	25
	<i>Mashkull</i>	0	2	4	6	1	14	4	9	40	75
	Total	0	2	6	12	2	15	4	12	53	100
Serbët	<i>Femër</i>	18	16	23	21	7	12	3	9	109	46
	<i>Mashkull</i>	19	14	20	19	13	18	10	13	126	54
	Total	37	30	43	40	20	30	13	22	235	100
Turqit	<i>Femër</i>	8	3	5	3	1	0	0	0	20	32
	<i>Mashkull</i>	6	2	7	7	8	4	4	4	42	68
	Total	14	5	12	10	9	4	4	4	62	100
Boshnjakët	<i>Femër</i>	5	4	8	11	7	3	1	0	39	48
	<i>Mashkull</i>	4	4	9	7	7	3	3	6	43	52
	Total	9	8	17	18	14	6	4	6	82	100
Romët	<i>Femër</i>	17	16	19	2	0	0	0	0	54	40
	<i>Mashkull</i>	23	16	35	5	1	0	1	1	82	60
	Total	40	32	54	7	1	0	1	1	136	100
Ashkalitë	<i>Femër</i>	12	4	13	2	0	1	0	0	32	35
	<i>Mashkull</i>	18	12	23	5	0	0	1	1	60	65
	Total	30	16	36	7	0	1	1	1	92	100
Egjiptianët	<i>Femër</i>	3	2	1	0	0	0	0	0	6	23
	<i>Mashkull</i>	3	4	11	2	0	0	0	0	20	77
	Total	6	6	12	2	0	0	0	0	26	100
Kroatët	<i>Femër</i>	2	1	3	4	0	1	0	0	11	65
	<i>Mashkull</i>	1	1	1	3	0	0	0	0	6	35
	Total	3	2	4	7	0	1	0	0	17	100
Goranët	<i>Femër</i>	4	3	2	2	0	0	0	0	11	31
	<i>Mashkull</i>	3	3	5	7	3	2	1	0	24	69
	Total	7	6	7	9	3	2	1	0	35	100
Total gjinia	<i>Femër</i>	69	49	76	51	16	18	4	12	295	40.
	<i>Mashkull</i>	77	58	115	61	33	41	24	34	443	60
	Total	146	107	191	112	49	59	28	46	738	100
% në kategori		19.8	14.5	25.9	15.2	6.6	8	3.8	6.2	100	-

Legjenda: DKA do të thotë Drejtoritë Komunale të Arsimit.

Hollësitë e të anketuarve sipas bashkësisë

Komuniteti	Femra	Meshkuj	Total	% e totalit	% femra	% meshkuj
<i>Shqiptar</i>	13	40	53	7.2	24.5	75.5
<i>Serb</i>	109	126	235	34.3	46.4	53.6
<i>Turk</i>	20	42	62	13.8	32.3	67.7
<i>Boshnjak</i>	39	43	82	19.2	47.6	52.4
<i>Rom</i>	54	82	136	33.5	39.7	60.3
<i>Ashkali</i>	32	60	92	24.9	34.8	65.2
<i>Egjiptian</i>	6	20	26	9.4	23.1	76.9
<i>Kroat</i>	11	6	17	6.7	64.7	35.3
<i>Goran</i>	11	24	35	14.9	31.4	68.6
Total	295	443	738	100	40	60

8. SHTOJCA 2. Përbërja etnike e Kosovës më 2005 dhe lista e profesioneve ku OSBE-ja ka bërë intervista për qëllimet e këtij raporti



Legjenda: **Kjo hartë nuk është dokument zyrtar dhe ofrohet vetëm për referim.** Tjerat harta përfshijnë edhe malazetët e Kosovës. Ky raport bazohet në intervista të kryera nga OSBE-ja në: Štrpce/Shtërpçë; Gjilan/Gnjilane; Novobërdë/Novo Brdo; Kamenicë/Kamenica; Ferizaj/Uroševac; Viti/Vitina; Obiliq/Obilić, Caravodicë/Crkvena Vodica, Babimoc/Babin Most dhe Plemetin/Plemetina (Obiliq/Obilić); Fushë Kosovë/Kosovo Polje; Lipjan/Lipljan, Hallaq i Vogël/Mali Alaš and Janjevë/Janjevo (Lipjan/Lipljan); Podujevë/Podujevo; Shtime/Štimlje; veri dhe jug të Mitrovicës/Mitrovica; Zvečan/Zveçan; Zubin Potok; Leposavić/Leposaviq; Skenderaj/Srbica; Vushtrri/Vučitrn; Pejë/Peć, Gorazdevac/Gorazhdec, Sigë/Siga and Brestovik/Brestovik (Pejë/Peć); Istog/Istok dhe Osojane/Osojan (Istog/Istok); Klinë/Klina; Deçan/Deçane; Prizren, Planjane/Piljanjan dhe Reçane/Recan (Prizren); Mamuša/Mamushë/Mamuša; Dragash/Dragaš, Mlike/Mlikë, Globočica/Glloboçicë, Ljubovište/Lubovishtë, Brod dhe Kruševo/Krushevë (Dragash/Dragaš); Rahovec/Orahovac dhe Velika Hoča/Hoçë e Madhe (Rahovec/Orahovac).

